

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri pjesa II



gtz



Ky botim u financua nga buxheti i shtetit në dispozicion të DAP. Përgatitja dhe përkthimi i materialeve u bashkëfinancua nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit e Gjermanisë dhe nga projektet e Bashkimit Europian IPA 2008 "Support to the Albanian Department of Public Administration" zbatuar nga GTZ (German Technical Cooperation).

Copyright ©
Departamenti i Administratës Publike
Shtator, 2010

Përgatiti për botim:
Evis Taska, MA
Nora Zela, MA

Arti grafik:
Viliem Kurtulaj

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
MINISTRIA E BRENDSHME
Sheshi Skënderbej, Nr 4, Tiranë; Kutia postare Nr. 1751
Tel: +355 4 2235937; Tel/Fax: +355 4 2251241
www.pad.gov.al

Përmbajtja

1. **Administratë Publike e angazhuar në përmbushjen e Reformave prioritare për Integrimin European5**
2. **Modernizimi i gjendjes civile - një realitet i prekshëm13**
 - *Zbatimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile në katër etapat e zhvillimit*
 - *Regjistri Kombëtar i Adresave*
 - *Dokumentet e identitetit*
3. **Sistemi elektronik për kontrollin e gjendjes gjyqësore - më pak burokraci për qytetarin35**
4. **Administrata Tatimore në funksion të drejtpërdrejtë të tatimpaguesve41**
 - *Reformat në administratën tatimore*
 - *Rezultatet e reformave tatimore*
 - *Synimet për të ardhmen*
 - *Të rejat në fushën e tatimeve (Regjistrimi i tatimpaguesve, deklarimi elektronik i tatimeve, komunikimi me biznesin)*

- 5. Shqipëria drejt Shoqërisë së Informacionit59**
- *Roli i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në mundësimin e teknologjisë së informacionit*
 - *Puna e AKEP në fushën e komunikimeve elektronike*
- 6. Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) - një institucion në zhvillim67**
- *Historik i shkurtër i QKR-së*
 - *Çfarë është arritur deri tani*
 - *Roli i QKR-së lidhur me procedurat e regjistrimit të biznesit*
- 7. Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) - tashmë një lehtësim për biznesin në Shqipëri85**
- *Procedura e licencimit*
 - *Shkurtimi i kohës dhe kostos*
 - *Regjistri Kombëtar i Lejeve dhe Licencave*
- 8. E- Qeverisja, nga koncept në realitet97**
- *Roli i TIK për mirëqeverisjen*
 - *E- Qeverisja dhe ndërveprimi me qytetarët*
 - *Drejtimet strategjike për zhvillimin e qeverisjes elektronike*
 - *Matja e qeverisjes elektronike*



**Administratë Publike e angazhuar në
përbushjen e Reformave prioritare
për Integrimin Europian**

Serinë e re të publikimeve të Departamentit të Administratës Publike e kam pritur me mjaft interes dhe mendoj se është një nismë e mirëvendosur, në kuadër të përpjekjeve të spikatura qeveritare për një administratë publike të motivuar dhe të gatshme për të kontribuar në reformat e mëdha të vendit drejt Bashkimit Europian. Gjithashtu, kjo nismë merr rëndësinë e vet edhe në kuadër të Projektit “Support to the Albanian Department of Public Administration” IPA 2008, zbatuar nga GTZ, për të patur një administratë publike të qëndrueshme, larg ndikimeve politike dhe, gjithnjë e më tepër të orientuar drejt cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Në këtë këndvështrim, është kënaqësi e veçantë të evidentoj faktin se përpjekjet dhe njëkohësisht arrijtet tona, të konkretizuara edhe me mbështetjen e Bashkimit Europian dhe Delegacionit Europian, janë në të njëjtën linjë me filozofinë dhe praktikën e mira europiane.

Të nderuar lexues!

Është momenti për të shprehur entuziazmin dhe mbështetjen e qytetarëve shqiptarë, për Vendimin e Këshillit të Ministrave të Brendshëm të Bashkimit Europian për liberalizimin e vizave në hapësirën Shengen. Duke e konsideruar këtë vendim, një vlerësim për politikën tonë, lidhur me përmbushjen dhe ruajtjen e standardeve të larta, është po kaq e rëndësishme të shprehim garantimin e cilësisë së këtyre standardeve, të cilat nuk mund të arrihen ndryshe, veçse me një vullnet të qartë politik, të kombinuar me seriozitetin, përgatitjen dhe përkushtimin e administratës publike.

Administrata Publike është një trupë e pazëvendësueshme në zbatimin e reformave dhe roli i saj në procesin e Integritimit Europian merr gjithmonë e më tepër një rëndësi të veçantë. Shtrirja vertikale dhe horizontale e reformave, kompleksiteti, sensibiliteti dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së tyre kërkojnë vëmendjen, inspirimin dhe aftësinë e duhur për t'i përkthyer në akte ligjore, nënligjore apo masa administrative të përshtatshme, duke e kthyer në domosdoshmëri përmirësimin radikal të sjelljes dhe statusit juridik të administratës sonë publike.

Iniciativat dhe sukseset tona, të njohura si:

- Zero tolerancë në luftën kundër korrupsionit;
- Thjeshtëzimi dhe rinovimi teknologjik i mjaft prej shërbimeve publike si: mbledhja e taksave, regjistrimi dhe licencimi i bizneseve, planifikimi urban, si dhe shërbime të tjera qendrore e lokale;
- Mbajtja e një administrate publike të vogël, efektive dhe të motivuar janë frymëzuar dhe zbatuar nga praktikantët e mira në shtete të Bashkimit Europian e më gjerë, të dalluara për një administratë publike të konsoliduar. Kjo është një tjetër arsye që na bën krenarë.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Unë do t'i lejoj vetes të përmend disa arritje të administratës së Ministrisë së Brendshme si dhe të njësive të qeverisjes vendore.

Në më pak se tre vjet, u konceptua dhe u realizua një mrekulli e teknologjisë dhe marrëdhënieve ndërinstitucionale shqiptare: Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC).

Ky regjistër funksionon on-line në gati 350 zyra të gjendjes civile dhe përfaqëson një data-bazë kombëtar, modern dhe të centralizuar të të gjitha të dhënave të gjendjes civile. Mbi 4.2 milion rekorde të qytetarëve shqiptarë janë transkriptuar elektronikisht në një regjistër qendror, duke respektuar standardet më të larta të sigurisë. Në fund të muajit tetor 2010, janë prodhuar mbi 2.4 milion letërnjoftime elektronike. Për mënyrën se si konsultohen sistemet me njëri-tjetrin, kjo nënkupton se, përveç sa më sipër, mbi 75% e shtetasve mbi 18 vjeç, i kanë verifikuar dhe çertifikuar personalisht të dhënat e hedhura në RKGJC, gjë që për nga mënyra e konsultimit, e bën këtë regjistër një nga bazat më solide europiane e botërore.

Krahas mbështetjes së Qeverisë Shqiptare, RKGJC përfaqëson një projekt të koordinuar mjaft mirë mes aktorëve të rëndësishëm, si:

- Ministrisë së Brendshme të Qeverisë Federale të Austrisë;
- Delegacionit të Bashkimit European me projektin “Për Modernizimin e Gjendjes Civile dhe Implementimin e Sistemit të Adresave”;
- Pranisë së OSBE-së, si agjenci zbatuese e Projektit “Për Modernizimin e Gjendjes Civile dhe Implementimin e Sistemit të Adresave”;
- Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë, nëpërmjet Institutit të Statistikave;
- Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), që me rreth 8 milion euro vuri në zbatim teknologjitë e fundit.

Kjo mbështetje, solli rezultate të prekshme, ndër të cilat mund të përmendim:

- Gjenerimin e numrit personal të Identitetit për çdo shtetas të Republikës së Shqipërisë;
- Mbajtjen, përpunimin dhe hedhjen elektronikisht të të dhënave të gjendjes civile, për çdo shtetas të Republikës së Shqipërisë;
- Ofrimin e shërbimit të gjendjes civile në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si një shërbim on-line me Regjistrin Qendror, në një kohë shumë më të shkurtër dhe me standard sigurie e cilësie, të pakrahasueshëm me atë më parë;
- Garantimin e funksionimit të regjistrit, në nivelet më të larta të sigurisë dhe përgjegjësisë, me procedura e protokolle funksionimi të siguruara nga programe pune e mirëmbajtjeje për bazat e të dhënave në nivelet më të mira të Bashkimit Europian.

Me këtë arritje, Shqipëria ka zgjidhur një herë e përgjithmonë çështjen e gjendjes civile në vend- prodhimin dhe administrimin modern të identitetit të shtetasve shqiptarë, duke ndikuar ndjeshëm në garantimin e listave të zgjedhësve për zgjedhjet e qershorit 2009.

Një tjetër arritje e administratës së Ministrisë së Brendshme, është edhe **Sistemi i Dokumenteve të Identitetit**. Në më pak se tre vjet, Shqipëria rikuperoi humbjen e kohës dhe dështimet e njëpasnjëshme të qeverive të mëparshme, për zgjidhjen e këtij problemi. Konsulenca të fuqishme ndërkombëtare, lidhur me Sistemet e Integruara të Identitetit, si dhe kombinim optimal të elementeve, përfshirë këtu edhe ato të sigurisë në vetë dokumentat e identitetit, lejuan Ministrinë e Brendshme që në vetëm 9 muaj, të ratifikonte Marrëveshjen Koncesionare me Grupimin franko-amerikan **Safran & AAEF**.

Sistemi i ri, i krijuar për më pak se katër muaj pas hyrjes në fuqi të Kontratës, siguroi:

- ngritjen e më shumë se 400 stacioneve të aplikimit në të gjithë Shqipërinë;
- ndërtimin e një qendre supermoderne të personalizimit të dokumenteve të Identitetit;
- ndërtimin e një programi që lejonte në të gjithë Shqipërinë konsultimin on-line me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- konceptimin dhe realizimin e dokumenteve të përsosura biometrike (letërnjoftimi dhe pasaporta), me elemente dhe parametra që përfaqësojnë brezin e fundit të teknologjisë botërore për këtë qëllim.

Këto dokumente, të pajisura me faqe të dhënash polikarbonat dhe personalizimi i të dhënave nëpërmjet teknologjisë “gdhendje me laser” (ku elementë të tillë si: UVD apo OVD, ndërthuren dhe personalizohen mjaft mirë), demonstrojnë natyrshëm vullnetin e qartë të shqiptarëve për integrim në strukturat euro-atlantike. Cilësia e këtyre dokumenteve bëhet e padiskutueshme, edhe si pasojë e mbajtjes së të dhënave në mënyrë elektronike në chip-e me kapacitet 72 kb.

Veç kësaj, Projekti u kujdes në kohë jashtëzakonisht të shkurtër, por duke përdorur maksimumin e kapaciteteve njerëzore, të realizonte në mënyrë masive pajisjen e shtetasve me letërnjoftim elektronik. Këto letërnjoftime u lejojnë shtetasve shqiptarë identifikim më të mirë për zgjedhjet e 28 qershorit 2009, mision i kryer me mjaft sukses nga sistemi i Prodhimit të Letërnjoftimeve elektronike, duke siguruar prodhimin dhe shpërndarjen e gati 1.4 milion letërnjoftimeve të reja, në rreth 4 muaj, gjithmonë përpara datës së zgjedhjeve.

Me prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike të Identitetit, Shqipëria çertifikoi dhe stabilizoi përfundimisht edhe shtyllën e dytë të identitetit- atë të çertifikimit të lehtë të tij, përmes dokumenteve moderne dhe tepër të besueshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë. Po kaq e sukseshme, puna e Ministrisë së Brendshme shfaqet edhe në zbatimin e deritanishëm të Projektit “Për Implementimin e sistemit të adresave”. Nëpërmjet një sistemi elektronik adresash dhe krijimit për herë të parë në Shqipëri të Regjistrimit të Adresave, po i jepet zgjidhje e plotë shtyllës së tretë të identitetit të shtetasve- asaj të lidhjes së tyre me territorin.

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Duke mos u ndalur në mënyrë të detajuar, do të doja së fundmi, të përmendja edhe disa arritje të tjera të rëndësishme të Ministrisë së Brendshme, lidhur me:

- Konsolidimin e procesit të decentralizimit dhe shtimin e fondeve për njësitë vendore dhe investimet në to, përkatësisht në 4 dhe 12 herë në krahasim me 2005. Një komponent i veçantë në këtë proces, është rritja në mënyrë të dukshme e transferimit të pronës publike drejt njësive të qeverisjes vendore, veçanërisht shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve dhe kullotave;

- Rritjen e performancës, gadishmërisë dhe koordinimit të emergjencave civile, duke përballuar me shumë sukses emergjenca të tilla si ajo e fillim - dhjetorit të vitit 2005, e verës së vitit 2008 dhe veçanërisht ajo e përmytjeve të 2009-2010.

Këto arritje, të kurorëzuara me angazhimin mjaft serioz e pasionant të administratës publike, lidhur dhe me dhënien e përgjigjeve të pyetësorit për statusin e vendit- kandidat, demonstrojnë se shërbimi

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

publik në Shqipëri, ka bërë progres impresiv, duke mos lënë pas dore faktin se shërbimi dhe administrata civile janë produkt i një procesi evolutiv afatgjatë. Megjithatë, sukseset e arritura na ndihmojnë për të verifikuar saktësinë e rrugës së ndjekur dhe për të marrë të gjitha masat që përmbushja e prioriteteve madhore të shoqërisë shqiptare të jetë në maksimumin e saj. Nga ana tjetër, ato na shërbejnë të punojmë së bashku, që konsolidimi i administratës publike të perceptohet si arritje gjerësisht e pranuar në ambientet dhe hapësirat europiane.

Ne jemi optimistë se përmbushja e këtyre prioriteteve, do të na çojë në një proces të qëndrueshëm dhe të pakthyeshëm sukseesi!

Faleminderit!

Ferdinand Poni

Zëvendësministër i Brendshëm

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Modernizimi i gjendjes civile - një realitet i prekshëm

- *Zbatimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile në katër etapat e zhvillimit*
- *Regjistri Kombëtar i Adresave*
- *Dokumentet e identitetit*

Modernizimi i gjendjes civile - një realitet i prekshëm

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është krijuar fillimisht me ligjin Nr. 8950, datë 10. 10. 2002, “Për Gjendjen Civile”, ku sanksionohet si organ drejtimi dhe kontrolli i shërbimit të gjendjes civile në Bashki/Njësi Bashkiake/Komuna dhe në Degët e Qarkut.

Ky ligj rregulloi dhe përcaktoi unifikimin e shërbimit të gjendjes civile, i cili u pasqyrua së pari në përdorimin e një modeli dokumentacioni. Ky dokumentacion prodhohej sipas standardeve të përcaktuara me anë të akteve nënligjore dhe u shpërndahej zyrate të gjendjes civile.

Ligji Nr. 8950, datë 10. 10. 2002 “Për gjendjen civile”, u shoqërua me një sërë aktesh të tjera ligjore dhe nënligjore.

Ndryshimet e thella në shërbimin e gjendjes civile u kryen gjatë viteve 2007-2009. Në këtë periudhë u hartuan dhe u zbatuan dy projekte shume të rëndësishme:

1. “Modernizimi i Shërbimit të Gjendjes Civile”, me anë të të cilit u krijua Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile. Nëpërmjet këtij regjistri të gjitha veprimet për hedhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të shtetasve përdoren në formë elektronike dhe on-line. Ministria e Brendshme (MB) dhe Drejtoria e saj e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC) janë autoritetet përgjegjëse për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Në këtë proces, MB-ja ka mbështetur e Projektit të Asistencës Teknike të OSBE-së me financim nga BE-ja për Modernizimin e sistemeve të Gjendjes Civile dhe Adresave, nga Statistics Norway dhe Ministria e Brendshme e Austrisë.

Zbatimi i Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile është zhvilluar në katër etapa:

1. Procesi i hedhjes së të dhënave nga Regjistrat Themeltarë në bazën elektronike të të dhënave

Hedhja e të dhënave nga Regjistrat Themeltarë në format elektronik, filloi në 5 nëntor 2007 dhe përfundoi në korrik 2008. Në fund të këtij procesi, u dixhitalizuan rreth 14 000 Regjistra Themeltarë, me afro 4,2 milion rekorde.

2. Mirëmbajtja e të dhënave dhe printimi i certifikatave

Pas etapës së hedhjes së të dhënave, etapa e radhës ishte mbajtja e përditësuar e të dhënave në bazën elektronike të tyre. Për këtë qëllim, u krijua një program kompjuterik i përkohshëm me ndihmën e Statistics Norway, që mundësoi përditësimin e të dhënave në bazat vendore të të dhënave, me ndryshimet që raportohen çdo ditë pranë ZGjC-ve. Përveç mbështetjes së procesit të përditësimit, ky program kompjuterik, për herë të parë, mundësoi printimin elektronik të certifikatave në muajin gusht 2008. Printimi i certifikatave, nisur nga ai moment, u bë i detyrueshëm për të gjitha Zyrat e Gjendjes Civile.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

The screenshot displays the NCR (National Civil Registry) portal interface. At the top, there is a navigation menu with options like 'Procesi i regjistrimit', 'Kërko person', and 'Kjo person'. Below this, a search bar and a list of search results are visible. The main content area shows a table of citizens, with columns for name, date of birth, gender, and registration status. The table is titled 'Personat e gjetur' and contains several entries.

Emri i identitetit	Data lindja	Lloji i vendbanimit	Kodi i kodit postar	Data lindja	Lloji i identitetit
Emri i identitetit: B905 [ikon]	15.05.1919	Rrethi	0000	15.05.1919	Regjistruar nga Migrim
Emri i identitetit: [ikon]	15.07.1931	Rrethi	0000	15.07.1931	Regjistruar nga Migrim
Emri i identitetit: [ikon]	14.02.1934	Rrethi	0000	14.02.1934	Regjistruar nga Migrim

The interface also includes a sidebar with various services and a top navigation bar with the NCR logo and search options.

Ndërfaqja grafike e RKGjC-së

3. Zhvillimi dhe funksionimi i infrastrukturës së rrjetit

Hapi tjetër në realizimin e këtij projekti ishte ngritja e një sistemi funksional qendror dhe vendor, si dhe infrastruktura e rrjetit për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Për këtë qëllim, Ministria e Brendshme filloi, në korrik 2008, punën për realizimin e një rrjeti komunikimi satelitor, të lidhura me databazën qendrore në DPGjC. Kjo punë, u përfundua në tetor 2008.

4. Zhvillimi i Regjistrit funksional Kombëtar të Gjendjes Civile

Faza e fundit ishte krijimi i sistemit përfundimtar online të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Për zhvillimin e këtij sistemi, Ministria e Brendshme nënshkroi një Marrëveshje me Ministrinë e Brendshme të Austrisë. Mbështetur në sistemin e gjendjes civile të Austrisë, sistemi ynë është ndërtuar dhe i përshtatur me nevojat e Shqipërisë. Puna për ngritjen e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile online, funksional dhe operacional, filloi në korrik 2008 dhe sistemi u bë operacional në dhjetor 2008.

Pas krijimit të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, puna filloi për pastrimin e rekordeve të shumëfishta, të njohura ndryshe si dublikimet. Për identifikimin e dublikimeve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile u hartuan procedurat e nevojshme. Pas identifikimit, puna për pastrimin e dublikimeve filloi nga Zyrat e Gjendjes Civile në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm të datës 26 janar 2009. Në fund të këtij procesi, u pastruan rreth 50 000 dublikime.

Një prej produkteve të një Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile online dhe funksional, është lista cilësore e zgjedhësve. Ndryshimet në të dhënat e gjendjes civile (lindja, vdekja, martesë, ndryshimi i vendbanimit) pasqyrohen online në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile nga ana e Zyrate të Gjendjes Civile. Çdo ndryshim i kryer në të dhënat e gjendjes civile në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile do të pasqyrohet automatikisht në listën e zgjedhësve. Rezultati është se Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile jep të dhëna të plota dhe të sakta të nevojshme për hartimin e listës cilësore të zgjedhësve. Më parë, lista e zgjedhësve hartohej mbi Regjistrat Themeltarë. Pas hartimit të listës, vetëm lista pastrohej nga dublikimet, ndërsa burimi parësor i informacionit, Regjistrat Themeltarë, nuk pastroheshin apo përditësoheshin, duke lënë dublikimet dhe të dhëna të pandryshuara në to, të cilat duheshin pastruar para të gjitha zgjedhjeve. Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, në qershor 2009, për here të parë, lista e zgjedhësve u gjenerua nga Regjistrat Elektronik Kombëtar i Gjendjes Civile. Mbështetur, në këto të dhëna, u përgatit lista paraprake e zgjedhësve. Ndryshimi i të dhënave të gjendjes civile bëhej nga Zyrat e Gjendjes Civile (vetëm me kërkesën e miratuar të qytetarit dhe në përputhje me ligjin), vetëm në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Gjendjes Civile. Në bazë të të dhënave të reja, u hartua lista përfundimtare e zgjedhësve.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Regjistri Kombëtar e Gjendjes Civile merr parasysh dhe garanton funksionalitete që përmbushin legjislacionin shqiptar dhe evropian në lidhje me të dhënat e gjendjes civile për çdo shtetas, lidhje on-line me zyrat e gjendjes civile, shërbim më të mirë për shtetasit dhe krijim të mundësive për t'u dhënë të dhëna nga Regjistri institucioneve shtetërore ose private, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentave të identitetit”, me anën e të cilit u bë e mundur prodhimi i letërnjoftimeve dhe pasaportave biometrike, si dokumenta të sigurisë së lartë. Këto dokumenta përmbajnë elementë të sigurisë sipas standardeve ndërkombëtare.



Pamje nga aplikimi kompjuterik i hedhjes së metadatave për imazhet e regjistrave. Ilustrimi i një imazhi fletë regjistri themeltar dhe djathtas hedhja e metadatave respektive.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

The screenshot displays the 'Regjistri elektronik i regjistrimit' web application. The interface includes a top navigation bar with options like 'Udhëzime', 'Regjistrime', 'Statistika', 'Import', 'Export', 'Printo', 'Shkarko...', 'Regjistri e papjekurshk', 'Shkarko...', 'Regjistri e papjekurshk', 'Printo', 'Shkarko...', 'Regjistri e papjekurshk', 'Printo', 'Shkarko...', 'Regjistri e papjekurshk', 'Printo'. Below the navigation bar, there are search and filter options including 'Kerko', 'Fishi', 'Nivisi', 'Penshësia', 'Nr. Regjistri', 'Emri Regjistri', 'Nr. Regjistri', 'Fishi', 'Nivisi', 'Penshësia', 'Nr. Fajës', 'Fajës e Funksi', 'Profundëtar', 'Ekspertuar', 'Shënime'. The main data table is as follows:

Emri Regjistri	Nr. Regjistri	Fishi	Nivisi	Penshësia	Nr. Fajës	Fajës e Funksi	Profundëtar	Ekspertuar	Shënime
TIRANE	19								
AI Dena	2	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	225				
AI Dena	3	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	222				
AI Dena	4	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	222				
AI Dena	5	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	201				
AI Dena	6	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	201				
AI Dena	7	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	200				
AI Dena	8	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	200				
AI Dena	9	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	201				
AI Dena	10	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	200				
AI Dena	11	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	201				
AI Dena	12	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	201				
AI Dena	13	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	215				
AI Dena	14	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	215				
AI Dena	15	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	198				
AI Dena	16	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	198				
AI Dena	17	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	217				
AI Dena	18	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	217				
AI Dena	19	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	110				
AI Dena	20	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	110				
AI Dena	21	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	201				
AI Dena	22	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	201				
AI Dena	23	TIRANE	Legjia 1	1950-1974	98				
AI Dena					175				

Pamje nga aplikimi kompjuterik i hedhjes së metadatave për imazhet e regjistrave

Gjithashtu pjesë e projektit “Modernizimi i shërbimit të gjendjes civile” është dhe ngritja e Regjistrit Kombëtar të Adresave. Edhe ky regjistër është në format elektronik dhe do të bëjë të mundur përdorimin e adresës së shtetasve nga ana e RKGJC. Gjatë zbatimit të këtij projekti u bë e mundur pajisja e shtetasve me numrin e identitetit, i cili gjenerohet automatikisht nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, sipas një algoritmi të përcaktuar me ligj.

Regjistri Kombëtar i Adresave

Regjistri Kombëtar i Adresave (RKA) është një aplikacion me bazë GIS. Përdorimi i kësaj teknologjie mundëson krijimin, arkivimin dhe menaxhimin e të dhënave hapësinore. Aplikacioni do të ofrojë mundësinë e lidhjes së ndërsjelltë me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC). Kjo nënkupton krijimin e një databaze të vetme ku do të lidhen të dhënat e dy sistemeve. RKA gjithashtu do të mundësojë analizimin dhe krijimin e raporteve specifike për adresat dhe banorët e tyre. Aktualisht ky aplikacion është në fazë testimi me të dhëna nga qytete, të cilat kanë mbaruar adresimin. Përfundimi i kësaj faze parashikohet të jetë në fund të vitit 2010, ku përllogaritet që të bashkëngjiten të gjitha informacionet e bashkive/komunave që kanë mbaruar procesin e adresimit.

Bazuar në angazhimet e marra nga Qeveria e Shqipërisë në kuadër të Partneritetit Evropian, përshtatja e shërbimit të gjendjes civile me standardet evropiane, u bë nëpërmjet një sërë konsultimesh me disa partnerë ndërkombëtarë të interesuar për këtë proces ku përfshihen: prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Komisioni Evropian (KE), Statistics



Pamje nga faja e Regjistrimit Kombëtar të Adresave

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Norway, USAID/IFES, NDI (Instituti i Zhvillimit Kombëtar), etj., ku si përfundim u arrit të vihet si objektivi që Sistemi i Regjistrimit të Popullsisë të jetë i gatshëm përpara zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë në 2009. Projekti filloi zyrtarisht në datën 5 shtator 2007 pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Projektit të Modernizimit të Gjendjes Civile.

Në vazhdimësi të kësaj faze do të vazhdohet me lidhjen Online me zyrat e urbanistikës së çdo NjQV-je. Pjesë e këtij aplikacioni janë 13 shtresat (layer):

- | | |
|-------------------|---------------------|
| 1. Rrugë | 2. Ndërtesa |
| 3. Numër Ndërtese | 4. Numër Hyrje |
| 5. Fasada | 6. Sheshe/Parqe |
| 7. Hidrografia | 8. Hekurudha |
| 9. Kufij Qarku | 10. Kufij Rrethi |
| 11. Kufij Nj.Q.V | 12. Kufij Zgjedhorë |
| 13. Kufij Postarë | |

Me synimin për të marrë eksperiencat më të mira europiane në fushën e regjistrimit civil, u organizuan disa takime, ku shtete si Belgjika, Austria dhe Spanja u treguan të gatshme të na ndihmonin në këtë drejtim. Më konkretë në propozimet e tyre dhe me një sistem më të konsoliduar të regjistrimit civil rezultoi të ishte Austria. Pas identifikimit të modelit që do të përdorej filluan negociatat që do të finalizoheshin me nënshkrimin e një marrëveshjeje.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Marrëveshja është miratuar me Ligjin nr. 9971 datë 28.07.2008 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për realizimin e një sistemi kompjuterik për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri”, dekretuar nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 5858 datë 31.07.2008.

Qeveria Austriake e dhuroi sistemin e vet të regjistrimit civil, ashtu siç funksionon në Austri. Qeveria Shqiptare pagoi për përshtatjen dhe modifikimet e nevojshme të këtij sistemi, koston prej 1,3 milion Euro. Pjesë e marrëveshjes ishte edhe mbështetja operacionale për një periudhë 2 vjeçare (2009-2010) në vlerën prej 300,000 Euro. Në total kostoja e mbuluar nga buxheti i shtetit për këtë marrëveshje, përfshirë edhe suportin për 2 vjet, është 1,9 milion Euro.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes me Ministrinë e Brendshme të Austrisë për ndërtimin e këtij sistemi, sistemi u dorëzua në dhjetor 2008.

Sistemi i ndërtuar bazohet tërësisht në sistemin austriak të regjistrimit civil dhe mishëron një sistem të plotë, online, funksional dhe operacional të Regjistrit të Gjendjes Civile. Sistemi u përshtat nga ekspertët e siguruar nga Ministria e Brendshme e Austrisë, për të realizuar Sistemin Shqiptar të Regjistrit Civil. Sistemi merr parasysh dhe garanton funksionalitete që kënaqin legjislacionin shqiptar dhe evropian lidhur me të dhënat e gjendjes civile për çdo shtetas, funksionimin on-line me zyrat e gjendjes civile si dhe krijimin e mundësive për t’u dhënë institucioneve shtetërore apo dhe private, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të dhëna nga ky regjistër.

Me sistemin online, në muajin dhjetor 2008 filluan nga puna 11 zyrat e gjendjes civile në Tiranë dhe në janar 2009 të gjitha zyrat e gjendjes

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

civile, (gjithsej 355 të tilla), filluan nga puna me sistemin online të RKGjC-së.

Sistemi online i RKGjC-së është i bazuar dhe aplikon një skemë të fortë sigurie:

- Sistemi bazohet në konceptin “Single login” nëpërmjet portalit.
- Regjistrohen të gjitha zyrat në portal dhe më pas të gjithë punonjësit për çdo zyrë.
- Komunikimi ZGJC-DPGJC është i sigurt, i koduar me ndihmën e certifikatave dixhitale të sigurisë.
- Çdo shtesë, pakësim apo ndryshim në sistem ruhet.
- Çdo transaksion tjetër ruhet për një periudhë 2 vjeçare (p.sh. kërkimi për një person, kush e ka kërkuar, kur dhe nga është bërë kërkesa, rezultati i shfaqur).

Ndërkohë, në muajin tetor 2008 filluan takimet për gjetjen e zgjidhjes së duhur teknike për realizimin e lidhjes online mes sistemit të RKGjC-së dhe sistemit të dokumentave të identitetit. Këto përpjekje u finalizuan me ndërtimin e ndërfaqes teknike dhe lidhjen mes dy sistemeve, falë ndihmës teknike nga ekspertët e Ministrisë së Brendshme të Austrisë. Kështu më 12 janar 2009, filloi zyrtarisht aplikimi i shtetasve shqiptarë për letërnjoftim elektronik, duke përdorur një sistem modern dhe të integruar me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Gjithashtu, për herë të parë listat e zgjedhësve janë gjeneruar nga RKGJC-ja dhe çdo njësi e qeverisjes vendore bazuar në këto të dhëna realizoi hartimin e Listave Paraprake dhe Përfundimtare të Zgjedhësve. Çdo ndryshim që kryhet mbi të dhënat e zgjedhësve reflektohet në

RKGJC dhe automatikisht pasqyrohet në Listën e Zgjedhësve, përsa kohë kjo e fundit është nënprodukt i Regjistrit. Ky ishte një progres shumë cilësor, i cili u evidentua qartë edhe në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR për zgjedhjet 2009.

Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile është burimi i vetëm zyrtar i informacionit të identitetit të shtetasve, dhe si i tillë ai do t'ju ofrojë këtë informacion edhe palëve të treta. Shembulli i parë i suksesshëm në këtë drejtim është ndërfaqja që u ndërtua mes RKGJC-së dhe Sistemit të Dokumentave të Identitetit. Në këtë mënyrë Sistemi i Dokumenteve të Identitetit është i lidhur online me RKGJC-në dhe të dhënat e aplikantit, merren direkt nga RKGJC-ja, nëpërmjet një lidhjeje online të sigurtë.

Në këtë mënyrë sistemi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile është praktikisht sistemi më i madh në Shqipëri, si përsa i përket numrit të klientëve online (zyra) ashtu edhe të shtrirjes në territor. Në pikun e aplikimit për Letërnjoftimet Elektronike në muajt mars – qershor 2009 sistemi shërbente duke qenë prezent dhe funksional në rreth 700 zyra me një numër total postesh pune (kompjuterë) prej 1100. Tani sistemi është prezent në 560 zyra, ku janë të lidhur online 900 kompjuterë.

Institucionet e tjera qeveritare, të cilat janë në fazën e ngritjes së sistemeve të tyre, po shfaqin një interesim në rritje për lidhjen online me sistemin e RKGJC-së.

Ndër institucionet e gatshme për t'u lidhur me RKGJC-në përmendim: Institutin e Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor, Institutin e Sigurimeve Shoqërore, INSTAT, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, etj. Për këtë qëllim po bashkëpunohet me Ministrinë e Brendshme të Austrisë, për të gjetur zgjidhjen e duhur teknike.

Përveç shtimit të funksionaliteteve të reja të sistemit të Regjistrit

Kombëtar të Gjendjes Civile, bashkëpunimi vazhdon me shërbimin e mirëmbajtjes”, që do të sigurojë shërbimet për vazhdimin dhe përmirësimin e një sistemi të plotë kompjuterik operacional për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri”. Mirëmbajtja e sistemit realizohet nga një kompani e specializuar austriake, e nënkontraktuar nga Ministria e Brendshme e Austrisë.

Në projektet e DPGJC-së përfshihet dixhitalizimi i Zyrave të Arkivave të Gjendjes Civile. Për këtë qëllim, po bashkëpunohet ngushtësisht me Statistics Norway dhe, më 1 tetor 2009 filloi puna në zyrën e parë, atë të Arkivës së Gjendjes Civile pranë Bashkisë së Tiranës. Bazuar në këtë eksperiencë po vazhdohet dixhitalizimi i të gjithë regjistrave themeltarë në të gjitha zyrat e Arkivave të Gjendjes Civile, i cili parashikohet të përfundojë në fund të vitit 2010.

Imazhet e prodhuara në çdo zyrë arkive transferohen në serverin qendror. Më pas, për çdo imazh hidhen të dhënat bazë, ose ndryshe metadatat, që konsistojnë në të dhënat e kryefamiljarit të regjistruar në këtë faqe të regjistrit themeltar. Hedhja e metadatave realizohet nëpërmjet një aplikimi kompjuterik të zhvilluar nga projekti i Statistics Norway.

Pas përfundimit të dixhitalizimit të regjistrave themeltarë, do të vazhdohet me dixhitalizimin e akteve, duke realizuar në këtë mënyrë dixhitalizimin e plotë të Zyrave të Arkivave të Gjendjes Civile. Kompletimi i kësaj fazë do të përmbyllë me sukses Modernizimin e Shërbimit të Gjendjes Civile në të gjitha hallkat e vet, duke realizuar një shndërrim total të këtij shërbimi, nga një shërbim i bazuar totalisht në punë manuale dhe informacione të ruajtura në letër, në një shërbim të bazuar në një sistem online të standardeve evropiane, ku qytetarëve u ofrohet një shërbim më i mirë, më i shpejtë dhe më afër tyre.

Dokumentet e Identitetit

Në kuadër të zbatimit të projektit të rëndësishëm për Qeverinë Shqiptare dhe kontratës Konkensionare, në bazë të Ligjit nr. 9972, të datës 28.07.2008, për ratifikimin e kësaj kontrate “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit “SAGEM Securite” & Fondit Shqiptaro - Amerikan të Ndërmarrjeve, u krijua si pjesë e strukturës së DPGJC-së, Drejtoria e Dokumenteve të Identitetit dhe Trajnimeve.

Procesi i aplikimit dhe pajisjes së shtetasve shqiptarë me letërnjoftim elektronik, nisi në 12 Janar 2009, fillimisht në NJQV-të më të mëdha në rrethin e Tiranës dhe në vazhdim u shtri në të gjithë vendin. Procesi i aplikimit për pasaporta biometrike, filloi më 25 Mars 2009. Pasaporta e parë biometrike, u tërhoq më 1 Maj 2009.

Duke qenë se pajisja e shtetasve me dokumentet e reja të identifikimit, përbën një prioritet të Qeverisë Shqiptare, në periudhën parazgjedhore, vëmendja më e madhe u fokusua në procesin e pajisjes me letërnjoftimin elektronik për zgjedhjet e 28 Qershor 2009, për Kuvendin e Shqipërisë, duke përballuar një volum të madh pune për të realizuar në kohë dhe me sukses objektivat kryesorë, si më poshtë:

- Shtrirjen dhe prezencën e menjëhershme në territor;
- Funksonimin uniform në çdo zyrë të aplikimit pavarësisht se ku ndodhej ajo;
- Mbledhjen në kohën e duhur të informacionit nga e gjithë Shqipëria;

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II



Fillimi i procesit të aplikimit - 12 Janar 2009



Prodhimi i Letërnjoftimit të parë – 2 Shkurt 2009

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

- Funksionimin me kohë të zgjatur dhe me intensitet të lartë;
- Zgjidhjen e të gjitha problemeve të lidhjes me Regjistrin Kombëtar të gjendjes Civile;
- Sigurimin dhe monitorimin e procesit të aplikimit dhe pajisjes me letërnjoftimin elektronik, në mënyrë të veçantë, zbatimin e të gjitha procedurave administrative dhe teknike sipas standardeve të kërkuara të sigurisë për dokumentet e identitetit dhe të sistemit në tërësi.

Për këtë qëllim janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

- Marrja e masave të nevojshme administrative dhe ligjore për përmbushjen e detyrimeve të Autoritetit (Ministria e Brendshme), në kuadër të zbatimit të kontratës konçensionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit “Sagem Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ratifikuar me Ligjin nr. 9972, datë 28. 07. 2008;

- Iniciativat Ligjore

Zbatimi i projektit filloi nga plotësimi i kuadrit ligjor. Për këtë qëllim, u finalizuan iniciativat për hartimin dhe miratimin e një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore.

- Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të kontratës “Prodhimi dhe Shpërndarjes së Dokumenteve të Identitetit për shtetasit shqiptarë” dhe përmbushjen e detyrimeve të kësaj kontrate, nga ana e kompanisë konçensionare;

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

-Vënia në dispozicion e numrit pa pagesë **0800 2121**, gjatë muajit Qershor 2009, në mbështetje të mbarëvajtjes së procesit të pajisjes së qytetarëve shqiptarë me letërnjoftim dhe pasaportë biometrike, si dhe dhënia e asistencës së nevojshme për pajisjen në kohë, të shtetasve me dokumente, gjatë gjithë ditëve të javës në orarin 08 : 00 – 22 : 00;

- Në vazhdim, vëmendje e veçantë është fokusuar në procesin e pajisjes së shtetasve me pasaportat e reja biometrike, ku statistikat e përditësuara deri në datën 30.09.2010, në procesin e pajisjes së shtetasve shqiptarë me dokumentet e reja të identifikimit janë si më poshtë:

Letërnjoftim elektronik

- Numri total i aplikimeve	2 367 103
- Numri total i letërnjoftimeve	
të shpërndara pranë ZGJC-ve	2 348 122
- Numri total i letërnjoftimeve të tërhequra	2 128 261

Pasaportë biometrike

- Numri total i aplikimeve	1 086 724
- Numri total i pasaportave	
të shpërndara pranë stacioneve të policisë	999 593
- Numri total i pasaportave të tërhequra	919 710

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

- Në fazën e aplikimit masiv numri i zyrave të aplikimit/posteve të punës për dokumentet e identitetit (letërnjoftimi dhe pasaporta biometrike) ishte 356 pranë ZGJC-ve, 1 pranë MPJ dhe 31 posteve të punës në stacionet e policisë/ në total 501 poste pune.

- Për njohjen e pasaportave të reja biometrike shqiptare, nga trupat diplomatike të akredituara në Shqipëri, janë dërguar nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, 300 specimene për secilën prej pasaportave biometrike (të zakonshme, të shërbimit dhe diplomatike), të shoqëruara me fletëpalosjet shpjeguese.

- Për të ndihmuar në njohjen dhe përdorimin efektiv të letërnjoftimit elektronik nga ana e institucioneve shtetërore janë dërguar specimene të letërnjoftimit elektronik dhe broshura të përshkrimit të letërnjoftimit të ri shqiptar.

- Në periudhën parazgjedhore janë përgatitur raporte të vazhdueshme mbi ecurinë e procesit të pajisjes së shtetasve shqiptarë me dokumentet e reja të identitetit. Është përgatitur dhe publikuar informacioni i përditësuar mbi ecurinë e procesit të pajisjes së shtetasve shqiptarë pa pasaportë, për periudhën parazgjedhore, në faqen Web të Ministrisë së Brendshme.

- Ndërtimi i faqes së internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në adresën <http://dpgjc.moi.gov.al>, e cila u prezantua për herë të parë në 4 Maj 2010. Faqja e internetit u ndërtua me mbështetjen e Projektit të Asistencës Teknike së projektit “*Modernizimi i Shërbimit të Gjendjes Civile*”, të zbatuar nga OSBE-ja dhe financuar nga BE.

- Përditësimi i informacionit në faqen e web-it të DPGJC-së, realizohet në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të DPGJC-së

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

- Miratimi nga parlamenti i shtesës së kontratës konçensionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e Kartave të Identitetit dhe të Pasaportave Elektronike“, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit “Sagem Securite“, Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, me ligjin nr. 9972, datë 28.07.2008, i ndryshuar. Në këtë shtesë kontrate janë parashikuar shërbimet shtesë si më poshtë:

I. Rritja e Kapacitetit prodhues për pasaporta biometrike në 6000 pasaporta/ditë

II. Hapja e zyrave të pajisjes me dokumente identiteti (letërnjoftim dhe pasaportë biometrike) pranë zyrave konsullore shqiptare në Athinë, Selanik, Romë, Milano

III. Pajisja me dokumente identiteti (letërnjoftim elektronik dhe dokumente udhëtimi) të shtetasve të huaj

IV. Procedura e pajisjes së përshpejtuar me dokumente identiteti (letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike) për rastet emergjente.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

**Sistemi elektronik për
kontrollin e gjendjes
gjyqësore - më pak
burokraci për qytetarin**

Sistemi elektronik për kontrollin e gjendjes gjyqësore - më pak burokraci për qytetarin

Në kuadër të iniciativave të Qeverisë shqiptare për Qeverisjen Elektronike, Ministria e Drejtësisë ofron shërbimin e kontrollit në mënyrë elektronike të gjendjes gjyqësore. Sistemi elektronik për kontrollin e gjendjes gjyqësore është shërbimi i parë i ngritur mbi rrjetin qeveritar E-GOVNET. Kuadri ligjor për ofrimin e këtij shërbimi është Ligji Nr.96 l 4, datë 21.9.2006, “Për Certifikatat Elektronike të Gjendjes Gjyqësore”.

Që prej fillimit të vitit 2008, Vërtetimi i Gjendjes Gjyqësore të shtetasve shqiptare ose e ashtuquajtura “Dëshmi e Penalitetit” nuk merret më në formë manuale nëpërmjet Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, por realizimi i këtij shërbimi bëhet në mënyrë elektronike. Zbatimi i këtij vendimi, synon përmirësimin e shërbimit administrativ ndaj shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj me leje qëndrimi në Shqipëri. Ndërkohë që përmirësimi i këtij shërbimi në këtë rast merret përsipër nga administrata shtetërore dhe ajo private ose diplomatike.

Janë 41 Institucione, të cilat pas aprovimit të ligjit “Për Certifikatat Elektronike të Gjendjes Gjyqësore”, “Për miratimin e institucioneve të autorizuara për verifikimin në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore si dhe të formularit të vetëdeklarimit”, kanë akses në një sistem të ri, i cili e ka ndryshuar tërësisht praktikën e re të aplikimit. Ndryshimi i praktikës konsiston në faktin se tashmë shtetasi duhet të plotësojë “Formularin e vetëdeklarimit” që ka bashkëngjitur dhe “Autorizimin për

të lejuar verifikimin e gjendjes gjyqësore”. Më pas institucioni duhet të furnizojë shtetasit me “formularë vetëdeklarimi” dhe pastaj, nëpërmjet personit të autorizuar nga Institucioni kryhet verifikimi në sistem.

Institucionet që përfituan nga Ligji “Për Certifikatat Elektronike të Gjendjes Gjyqësore”, janë si më poshtë :

1. Zyra e Presidentit të Republikës;
2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë;
3. Prokuroria e Përgjithshme;
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
5. Ministria e Drejtësisë;
6. Ministria e Brendshme;
7. Ministria e Mbrojtjes;
8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
9. Ministria e Punëve të Jashtme;
10. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
11. Ministria e Financave;
12. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
13. Shërbimi Informativ i Shtetit;
14. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
15. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
16. Interpoli;
17. Garda e Republikës së Shqipërisë;
18. Departamenti i Administratës Publike;
19. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
20. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
21. Përfaqësitë diplomatike, me autorizim të Ministrisë së Punëve të Jashtme;

22. Banka e Shqipërisë;
23. Përfaqësia e Bashkimit Europian në Republikën e Shqipërisë;
24. Përfaqësia e Këshillit të Europës në Republikën e Shqipërisë;
25. Përfaqësia e NATO-s në Republikën e Shqipërisë.
26. Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
27. Gjykata Kushtetuese;
28. Enti Rregullator i Energjisë;
29. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
30. Ministria e Mbrojtjes për Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Shërbimin Informativ Ushtarak;
31. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe drejtorinë rajonale të punësimit, Tiranë;
32. Ministria e Shëndetësisë, për drejtorinë e shëndetit publik, Pogradec;
33. Ministria e Financave, për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore;
34. Këshilli i Ministrave, për Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
35. Ministria e Brendshme, për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm;
36. Ministria e Punëve të Jashtme, për shërbimet diplomatike;
37. Kontrolli i Lartë i Shtetit;
38. Bashkia Korçë;
39. Autoriteti i Aviacionit Civil;
40. Shkolla e Magjistraturës;
41. Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë (ERRU);

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Të gjithë Institucionet e mësipërme lidhen nëpërmjet internetit me “Database” e çertifikatës elektronike on-line në serverin e Ministrisë të Drejtësisë. Kjo lidhje realizohet me dy mënyra:

a) Duke përdorur rrjetin GOVNET (i cili përfshin të gjitha institucione, të cilët janë në këtë rrjet),

b) Duke përdorur VPN (Virtual Private Networking, i cili përfshin të gjitha institucionet, të cilët nuk janë në rrjetin GOVNET).

Aksesimi i bazës së të dhënave bëhet nëpërmjet sistemit “Fingerprinter” duke garantuar teknikisht pamundësinë e manipulimit të regjistrimit elektronik. Baza e të dhënave përditësohet me informacionin që vjen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Sipas statistikave të gjeneruara nga Sistemi on-line për kontrollin e gjendjes gjyqësore, numri i kërtimeve dhe printimeve për të gjitha institucionet, të cilët kanë akses gjatë periudhës 2008 – shtator 2010 janë si më poshtë:

VITET	NUMRI I KËRKIMEVE	NUMRI I PRINTIMEVE
2008	9.020	10.181
2009	21.579	10.561
Janar 2010 – 24 Shtator 2010	16.847	6.585

Dëshmitë e Penalitetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Që prej datës 31.01.2008 ndërmjet Postës Shqiptare sh.a dhe D.P.B (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), realizohet shërbimi i pranimit, përpunimit dhe shpërndarjes së dëshmime të penalitetit, nëpërmjet shërbimit postar të brendshëm për gjithë territorin e vëndit, me tarifat e përcaktuara në kontratë.

Rastet kur personat mund të aplikojnë pranë sporteleve postare për t'u pajisur me dëshmi penaliteti:

- Kur personat kërkojnë vërtetim të gjendjes gjyqësore për dënim;
- Kur personat kërkojnë vërtetim të gjendjes gjyqësore për Ambasada;
- Kur personat kërkojnë vërtetim të gjendjes gjyqësore për jashtë shtetit;

Procedurat për të përftuar nga këto shërbime janë shumë të thjeshta. Qytetari shqiptar për të bërë aplikimin pranë sporteleve të postës, duhet të paraqesë çertifikatën origjinale, ose fotokopjen e letërnjoftimit të personit që do të aplikojë për dëshmi penaliteti. Ai gjithashtu duhet të plotësojë formularin e aplikimit për çertifikatën e gjendjes gjyqësore dhe ta dorëzojë bashkë me çertifikatën ose fotokopjen e letërnjoftimit.

Administrata Tatimore në funksion të drejtpërdrejtë të tatimpaguesve

- *Reformat në administratën tatimore*
- *Rezultatet e reformave tatimore*
- *Synimet për të ardhmen*
- *Të rejat në fushën e tatimeve (Regjistrimi i tatimpaguesve, deklarimi elektronik i tatimeve, komunikimi me biznesin)*

Administrata Tatimore në funksion të drejtpërdrejtë të tatimpaguesve

Prej më se tre vjetësh administrata tatimore është përfshirë në një proces përmirësimi dhe reformimi për të arritur standarde të një administrate moderne, transparente, efikase dhe në shërbim të tatimpaguesve. Ndryshimet e mëdha të realizuara në kuadrin ligjor dhe organizativ, kanë bërë të mundur zgjerimin e kapaciteteve të jashtme dhe të brendshme teknologjike, ofrimin e shërbimeve elektronike për të ndihmuar tatimpaguesit në plotësimin e detyrimit të tyre ligjor, zvogëlimin e pushtetit të panevojshëm të përqendruar në duart e administratorëve tatimorë, thellimin e transparencës, ngritjen e ndërgjegjësimit të tatimpaguesve për të rritur shkallën e vetëdeklarimit. Në këtë proces reformimi kjo administratë ka patur një ndihmë të madhe nga Programi Prag i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, i ofruar nëpërmjet USAID.

Qëllimi i kësaj reforme është përkufizimi i misionit parësor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve përmes vendosjes së rregullave dhe procedurave: nxitjen në një shkallë sa më të lartë të vetëdeklarimit, për të bërë të mundur mbledhjen e sasisë së duhur të tatimeve nga të gjithë tatimpaguesit.

Deklarimi elektronik i detyrimeve tatimore, mundësia e pagimit elektronik të këtyre detyrimeve, ofrimi i komunikimit elektronik dhe i shërbimeve elektronike për tatimpaguesit, deklarimi elektronik i librave të shitjes dhe të blerjes, transmetimi on line i të dhënave nga kasat fiskale, përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll tatimor nëpërmjet analizës së riskut dhe në të ardhmen deklarimi elektronik i listëpagesave të sigurimeve shoqërore, janë instrumentet bashkëkohore për të arritur balancin e duhur midis synimit të mbledhjes së të ardhurave dhe përmbushjes të të drejtave të tatimpaguesve.

Administrata tatimore do të vazhdojë në të ardhmen të jetë e angazhuar në shërbim të tatimpaguesve për të siguruar zbatimin vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet edukimit dhe përmirësimit të klimës së bashkëpunimit të ndërsjelltë.

Gazmir Spahija

Drejtor

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Reformat në administratën tatimore

Reformat në Administratën Tatimore erdhën si një kërkesë e domosdoshme e të gjithë zhvillimit ekonomik e social të vendit, të një rritje ekonomike të vrullshme, të një kërkesë gjithnjë e në rritje për reformim të insitucioneve, për t'iu përgjigjur sa më shpejt këtyre zhvillimeve, si dhe kërkesës aq të domosdoshme dhe vizionit për integrim në Bashkimin Europian. Për këtë arsye, Shqipëria është një ndër vendet me ritmin më të lartë të reformave gjatë këtyre viteve, për sa i përket reformave në administratën tatimore.

Rregullimi i legjislacionit fiskal, duke e përafuar atë me vendet e Bashkimit Europian, ndryshimi i shkallëve tatimore me qëllim rritjen e të ardhurave tatimore dhe zgjerimin sa më mirë të bazës së tatimpaguesve, ndërgjegjësimi i tatimpaguesve për pagimin e detyrimeve të tyre, modernizimi i administratës me qëllim kryesor uljen e kostove administrative për grumbullimin e të ardhurave, rritjen e nivelit të shërbimeve ndaj tatimpaguesve si një shkallë e domosdoshme në rritjen e nivelit të grumbullimit të të ardhurave, rritja e transparencës administratë tatimore –tatimpagues si një mjet i fuqishëm për reduktimin sa më maksimal të sjelljeve korruptive apo presioneve të ndërsjellta korruptive, janë disa nga fushat ku kjo reformë u përqendrua.

Rezultatet e reformave

Ligji i ri i Procedurave tatimore ka ndryshuar rrënjësisht misionin, funksionimin dhe organizimin e kësaj administrate.



SITUATA NE DEKLARIMIN ELEKTRONIK



1. 14 DREJTORI RAJONALE
2. ME SHUME SE 100 000 TATIMPAGUES
3. DEKLARATA TVSH-se
4. DEKLARATA SIG.SHOQERORE
5. DEKLARATA TAP-it
6. KESTET MUJORE TE TATIM FITIMIT
7. TATIM FITIMI VJETOR
8. TATIMI MBI TE ARDHURAT PERSONALE BIZNESI I VOGEL

Ilustrative për deklarimin elektronik të tatimeve: hapësira që përfshin si dhe llojet e deklaratave, numrin e tatimpaguesve

Transformimi i misionit të Administratës tatimore nga një mision për të plotësuar objektivin e mbledhjes së të ardhurave tatimore, në promovimin e respektimit vullnetar për ta përmirësuar këtë mbledhje të ardhurash, ka patur si synim të vetin reduktimin e barrës së administratës tatimore dhe hapësirës për korrupsion, përmes strukturës së re funksionale dhe ristrukturimit në menaxhim, reduktimin e ekonomisë së zezë, përmes praktikave moderne të administratës tatimore, vendosja e një ekuilibri më të mirë ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve të tatimpaguesve, ndihmë në modernizimin e klimës së biznesit në Shqipëri, përmes eliminimit të pengesave tatimore për investim, mbështetje e Integritimit Evropian, përmes praktikave ndërkombëtare tatimore në administratën tatimore.

Reforma organizative si rrjedhojë e funksionimit të Ligjit të ri të procedurave tatimore, ka patur si synim rritjen e besimit të publikut tek administrata tatimore, trajtimin e të gjithë tatimpaguesve në mënyrë të barabartë, ndershmëri dhe transparencë, në mënyrë që të nxitet vetëvlerësimi dhe të ulen kostot e pajtueshmërisë, si për administratën tatimore, ashtu edhe për tatimpaguesit, sigurimin se të gjithë punonjësit tatimorë, mbajnë përgjegjësi për rezultatet e arritura, në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe ndershmëria e organizatës në përgjithësi dhe të përmirësohen aftësitë e secilit prej punonjësve, standardizim më të madh të punës me tatimet, lehtësimin e përdorimit të teknologjive moderne për të përmirësuar efikasitetin e sistemit, monitorimin më të mirë të punës së stafit, duke qenë se ata janë specialistë, krijimin e një sistemi me autoritet kontrollues e balancues që redukton korrupsionin, sepse zyrtari tatimor nuk trajton të gjitha çështjet tatimore që lidhen me një tatimpagues.

Reforma në aspektin organizativ konsistoi në krijimin e 14 Drejtorive Rajonale dhe 23 Agjencive të Shërbimit në vend të 37 degëve tatimore të mëparshme. Ky riorganizim kishte për qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore si dhe krijimin e një vartësie vertikale të qartë nëpërmjet zyrave qendrore dhe drejtorive rajonale.

Janë ofruar shërbime të shumta elektronike për të lehtësuar tatimpaguesit në plotësimin e detyrimeve të tyre përkundrejt administratës tatimore, por njëkohësisht për të ulur edhe kostot e biznesit të tyre në realizimin e këtyre detyrimeve. Në faqen zyrtare të internetit të Administratës Tatimore www.tatime.gov.al, “Tatimet e mia”, janë tashmë funksionale deklaratat elektronike me të dhënat identifikuese të tatimpaguesve të plotësuar nga sistemi, për tatimet që vijnë:

- Formulari i Deklarimit dhe i Pagesës së TVSH-së;
- Formulari i Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi;

DPT
DREJTORIA E
PERGJITHSHME
E TATIMEVE

Welcome, Iurie Coroban

Kërko: Documents Advanced search

Find: Emri i Formularit View: DownloadForms

Emri i Formularit	Madhësia	Prapas...	Dosje	Ngarko Datën
▶ FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SE TVSH	281,648.00 .pdf		DownloadForms	2007-07-16
▶ Social and Health contributions form -shqip	297,391.00 .pdf		DownloadForms	2007-05-11
▶ Profit Tax Declaration Form eng	169,922.00 .pdf		DownloadForms	2007-05-11
▶ VAT tax declaration form eng	171,884.00 .pdf		DownloadForms	2007-04-26

1 of 4 selected (found 4).

2007© Developed by Alfa XP Web Software LLC, in partnership with Chemonics International, under the Millennium Challenge Account Threshold Project administered by the U.S. Agency for International Development Albania Mission. Legal disclaimer.Privacy statement. Accessibility issues.

Ilustrim i llogarisë elektronike të tatimpaguesit, që ndodhet në web site-in e DPT-së, nga e cila ai bën deklarinin elektronik të detyrimeve tatimore.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

- Formulari i Deklarimit & Pagesës së Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore.
- Formularët për pagesat paradhënie të tatimit mbi fitimin
- Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin Vjetor.
- Formularin e Deklarimit dhe Pagesës Vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël

Këta formularë u janë shpërndarë më shumë se 100 mijë tatimpaguesve në të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore, shkarkim të deklaratave për tatimpaguesit e biznesit të vogël, njohja në çdo kohë me situatën e tyre në Sistemin Informatik Tatimor nëpërmjet Librit të tyre të Llogarive, menaxhim të kontakteve me tatimpaguesit nëpërmjet një sistemi bashkëkohor elektronik, i cili rrit ndjeshëm transparencën dhe besueshmërinë tek administrata tatimore, komunikime online me insitucionet me të cilat bashkëpunon DPT-ja nëpërmjet rrjetit e-gov, një sistem modern të informatizuar për kryerjen e analizës së riskut në përzgjedhjen e tatimpaguesve për kontrollin tatimor, duke u larguar nga eksperiencat e shkuara të përzgjedhjes preferenciale.

Në këtë betejë të madhe të reformimit dhe modernizimit të Administratës Tatimore, një rol të pamohueshëm kanë edhe partnerët e rëndësishëm që kanë mbështetur.

Projekti Prag Sfida e Mijëvjeçarit – të USAID, ka dhënë një asistencë të plotë në të gjithë komponentët e Administratës Tatimore Shqiptare. Falë këtij projekti, sot ne kemi në përdorim Sistemin e Deklarimit dhe Pagesës Elektronike të Detyrimeve Tatimore të Tatimpaguesve, kemi një ligj bashkëkohor të ri të Procedurave Tatimore, si dhe një strukturë funksionale e bashkëkohore.

Një tjetër asistencë pranë Administratës Tatimore kanë qenë projektet e Komisionit Evropian. Projekti CAFAO (Zyra e Asistencës Teknike në Tatime dhe Dogana), ka asistuar në përmirësimin e teknologjisë së

informacionit, si dhe përgatitjen e Memorandumit për krijimin e Zyrës Hetimore të Krimin Tatimor etj.

Bashkimi Evropian, po asiston Administratën Tatimore me një tjetër projekt IPA (Instrumentat Para Aderimit), për të cilin tashmë janë hedhur hapat e para.

Po kështu, Qeveria Suedeze, nëpërmjet Agjencisë së saj “SIDA”, ka asistuar administratën tatimore për disa vjet. Falë tyre, ne tashmë kemi hartuar Manualin e Kontrollit për Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj, Metodikën e Parë të Shënimeve të Industrisë për Sektorin e Ndërtimit, Raportin për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore apo atij të Mbledhjes me Forcë dhe Menaxhimit të Borxhit, si dhe kemi për të bashkëpunuar në disa komponentë të tjerë për vitet në vazhdim.

Synimet për të ardhmen

Zgjerimi i shërbimeve elektronike për tatimpaguesit është ndër objektivat kryesorë për të ardhmen. Ndër to mund të përmendim ofrimin e të gjithë tipeve të formularëve të deklarimeve tatimore në mënyrë elektronike, marrjen e vërtetimeve të situatave tatimore të tatimpaguesve online, deklarimin e listëpagesave dhe Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, raportimet vjetore të tatimpaguesve etj.

Rritja e cilësisë së shërbimeve, si dhe zbatimi i detyrimit për një trajtim të barabartë të të gjithë tatimpaguesve ka për objektiv zgjerimin e rrjetit të Qendrave të Kontaktit të Tatimpaguesve në të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore, mundësinë e ofrimit të shërbimeve të karakterit one stop shop, si dhe ofrimit të teknologjive të reja të komunikimit me tatimpaguesit për t’i informuar ata në kohë reale me ndryshimet ligjore

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II



Shërbimi i tatimpaguesve përpara vitit 2007





*Qendra e re e shërbimit të tatimpaguesve për Tatimpaguesit e Mëdhenj,
inaguruar më 15.10.2007*

që ndodhin apo me kohën e shlyerjes së detyrimeve të tyre.



Automatizim i të gjitha proceseve të Administratës Tatimore është sfida e brendshme, me të cilën kërkohet të rritet niveli i informatizimit të proceseve të brendshme përpunuese.

Mbi të gjitha, kjo Administratë do të vazhdojë të ofrojë një partneritet të hapur me tatimpaguesit, një bashkëpunim gjithnjë e më të madh me organizatat profesionale dhe do të japë një shkallë informimi sa më të gjerë për publikun dhe, sidomos për brezin e ri për të kuptuar dhe njohur rëndësinë e pagimit të detyrimeve tatimore në jetën social-ekonomike të vendit.

*Paraqitja grafike e deklaratave të përfunduara për
TVSH, SIG, TAP
Janar - Shtator 2010*



Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II



ELIDA KARAJ

Specialiste në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve (DSHT),
Drejtoria Rajonale Tatimore
Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DRT-NJTM)

ANIDA KOSTI

Specialiste në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)

Çfarë të rejash solli krijimi i Drejtorisë së Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve për deklarin e tatimeve?

Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve, si një strukturë brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ka luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e administratës tatimore. E krijuar në 15 Tetor 2007, kjo drejtori ka patur si qëllim kryesor të saj ofrimin e një shërbimi sa më të shpejtë në kohë dhe efikas për të gjithë tatimpaguesit, shërbim ky i ofruar nga një staf specialistësh të trajnuar e të kualifikuar.

Një nga risitë për deklarimin e tatimeve, është edhe deklarimi elektronik. Si kryhet aktualisht kjo formë deklarimi?

Si pjesë e projektit “Sfida e Mijëvjeçarit”, projekt ky i administruar nga USAID, një rëndësi e madhe i është dhënë deklarimit elektronik (e-filing) të tatimeve. Deklarimi elektronik konsiston në plotësimin dhe dorëzimin në mënyrë elektronike të formularëve tatimorë të TVSH-së, Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, Tatimit mbi të Adhurat nga Punësimi, Tatimit mbi Fitimin, dhe së fundmi, të Librave të Shitjes e të Blerjes. Deklarimi i parë elektronik ka filluar pikërisht me krijimin e kësaj drejtorie në Tetor të vitit 2010, fillimisht për subjektet e Njesisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (VIP). Më pas, kjo skemë është zgjeruar, duke vazhduar me biznesin e madh të Drejtorisë Rajonale të Tiranës, e së fundmi, duke e bërë këtë lloj deklarimi të detyrueshëm për të gjithë subjektet e Drejtorive Rajonale, që janë subjekt i TVSH-së.

Në mënyrë që këto shërbime tatimore elektronike të bëheshin të njohura nga pjesa e bizneseve në të gjithë vendin, Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve, nisi një valë fushatash informimi dhe ndërgjegjësimi. Kështu, u përgatitën fletëpalosje të shumta, lajmërimet me shkresa zyrtare dhe lajmërimet në adresat elektronike të çdo subjekti, fushata publicitare që transmetoheshin në televizion dhe në radio, të cilat ftonin të gjithë tatimpaguesit të përdornin deklarimin elektronik të tatimeve, si një mënyrë e thjeshtë, e shpejtë, me kosto të ulët dhe që reduktonte takimet e shpeshta me inspektorët tatimore.

Rëndësi të veçantë iu vu edhe takimeve e trajnimeve të ndryshme të zhvilluara me komunitetin e biznesit, duke diskutuar në këtë mënyrë vështirësitë që mund të hasnin ata gjatë deklaramit dhe se si mundej kjo drejtori ta bente sa më të lehtë e më të kuptueshme deklaramin e taksave në mënyrë elektronike.

Procedura e deklaramit elektronik kërkon krijimin e një kapaciteti infrastrukturor (lidhja me internet) si dhe një nivel njohurish në fushën e teknologjisë së informacionit lidhur me përdorimin e paketave të programeve kompjuterike si MS Office nga ana e biznesit. Kështu, gjatë trajnimeve të shumta, tatimpaguesve u janë treguar të gjitha cilësitë dhe formatimet që duhet të ketë një deklaratë tatimore elektronike, në mënyrë që ajo të jetë e pranueshme nga sistemi tatimor, duke ulur kështu mundësinë e mospranimit nga sistemi dhe marrjen e gjobave tatimore për deklaram jo të saktë.

Drejtorja e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve nuk kryen vetëm asistimin dhe informimin e biznesit për shërbimet elektronike, por përfshin dhe shumë funksione të tjera në ndihmë të tatimpaguesit. Kjo drejtori, është konsideruar si pika e parë e kontaktit për komunitetin e biznesit, për probleme të ndryshme që ata mund të hasin në punën e tyre dhe asistencë në lidhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

Në ç' mënyrë zhvillohet komunikimi juaj me bizneset?

Përdoren mënyra të ndryshme komunikimi me çdo biznes dhe më të shpeshtat janë:

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

- Vizita në faqen zyrtare www.tatime.gov.al ku mund të merret informacion i përditësuar mbi legjislacionin tatimor;
- vizitat në sportelet e Drejtorive të Shërbimit çdo ditë të javës nga ora 800-1600;
- komunikimi me telefon, duke i dhënë mundësi subjekteve të marrin informacion në kohë të shpejtë dhe me kosto të ulët, e duke evituar në këtë mënyrë ardhjen deri në sportel;
- dërgimi i informacionit në mënyrë elektronike (e-mail) në adresën e çdo subjekti;
- shkresat me postë;
- sistemi CRM (Customer Relation Management), një sistem që bën të mundur njoftimin në faqen personale të subjektit për ndryshimet në lidhje me legjislacionin në fuqi, apo çdo informacion tjetër i nevojshëm për t'u komunikuar etj.

Në përfundim, mund të themi që stafi i drejtorive të shërbimit në të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore është një staf profesionist, i trajnuar dhe ndodhet në dispozicion të komunitetit të biznesit për ndërgjegjësimin, edukimin dhe informimin e tyre në lidhje me shërbimet që mund të marrin, duke bërë të mundur kështu përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Shqipëria drejt Shoqërisë së Informacionit

- *Roli i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në mundësimin e teknologjisë së informacionit*
- *Puna e AKEP-it në fushën e komunikimeve elektronike*

Shqipëria drejt Shoqërisë së Informacionit

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili që nga viti 2008 mbikëqyr kuadrin rregullator “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

AKEP nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike promovon konkurrencën dhe infrastrukturën efiçente në komunikimet elektronike, duke garantuar shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë

Të mund të marrësh dhe ndash informacionin me shpejtësi të madhe, rrit prodhimin, ndihmon tregun dhe mbështet rrugën drejt së resë. Aksesin në Internet me brez të gjerë ka një potencial të veçantë për të arritur pothuajse të gjitha fushat e jetës.

Vizioni ynë është përparimi i Shqipërisë drejt shoqërisë së informacionit ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen të efektshmërisë dhe të transparencës.

Aksesi në Internet me brez të gjerë sot është faktori kryesor i konkurrencës dhe rritjes ekonomike dhe sociale të një vendi.

AKEP gjatë vitit 2010 do të lëshojë autorizime për përdorimin e brezave të frekuencave 1.9 Ghz- 2.1 Ghz, që do të mundësojnë kryesisht përdorimin e teknologjisë UMTS, teknologji që ofron shërbime interneti me brez të gjerë.

Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur një zbatim shumë më i shpejtë i aplikacioneve të ndryshme, në radhë të parë të atyre që lidhen me mirëqeverisjen dhe kryesisht me e-gov si dhe të biznesit , bankave , edukimit dhe shkencës.

Piro Xhixho

Kryetar

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator sipas ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”

AKEP nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike promovon konkurrencën dhe infrastrukturën eficiente në komunikimet elektronike duke garantuar shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II


Investitorët që dëshirojnë të ofrojnë shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, kanë të drejtën që me një minimum të detyrimeve administrative, të pajisen nga AKEP me Autorizimin e Përgjithshëm, që është edhe një nga risitë kryesore të ligjit 9918, në përputhje me direktivat e BE-së.

Tregu në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit.

- 90 është numri i sipërmarrësve, ofrues të shërbimit të Internetit, ISP (Internet Service Provider);
- 90 mijë pajtimtarë, akses në internet me bandë të gjerë në fund të vitit 2009;
 - 12% e familjeve;
 - 2.5 numri i linjave broadband për 100 banorë;
 - 22 numri mesatar i linjave broadband për 100 banorë në vendet e BE-se;
- Albtelecomi:
- Reduktimi i tarifave të shërbimit broadband nëpërmjet ADSL në masën 50%;
- Numri i linjave ADSL: 60 mijë.

Numri i përdoruesve të Internetit në Shqipëri është rritur dukshëm gjatë viteve të fundit, gjë që është e lidhur me penetrimin e aksesit të Internetit me brez të gjerë. Grafiku më poshtë paraqet rritjen e numrit të përdoruesve të internetit gjatë tre viteve të fundit.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II



Numri i përdoruesve të internetit

Aksesi në Internet me Dial Up ka ardhur në rënie si pasojë e përdorimit të aksesit me bandë të gjerë dhe në fund të viti 2009, ishin rreth 14 mijë përdorues krahasuar me 25 mijë në vitet e mëparshme.

Gjithashtu, ekziston dhe një numër i madh Internet kafe (rreth 600), si dhe një numër i konsiderueshëm qendrash Interneti pa tel (Wi-Fi) në pika publike.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Deri në fund të vitit 2009 numri i pajtimtarëve celularë, që kanë akses në internet


- 785 mijë : aparat celular;
- 4 mijë: karta modem me PC (lap top);
- 60 mijë: numri i përdoruesve në të dyja këto forma aksesese në Internet;

Shërbimet me brez të gjerë ofrohen nga operatorët e rrjeteve fikse. Penetrimi i Internetit në Shqipëri deri në fund të vitit 2009 është 31.69%;

- 48.8% e përdoruesve të Internetit janë femra;
- 51.1% e përdoruesve të Internetit janë meshkuj;

Penetrimi i brezit të gjerë mbetet më i ulëti në Europë, duke qenë sa një e treta e mesatares së nivelit të Europës Jug-lindore.

Penetrimi I brezit të gjerë



Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Gjerësia e brezit të aksesit në Internetin global (International Internet Bandwith) është afërsisht 6 Gbps.

Teknologjitë e përdorura për Internet me brez të gjerë janë kryesisht ADSL nga Albtelecom, ADSL 2+, SDSL, duke ofruar lidhje kabllore (përshirë TV kabëll dhe Fibër Optike), Wireless Access dhe Satelitore nga operatorët alternative.

AKEP-i është administratori dhe regjistruesi i Domain-ve dhe nën-domain-ve ‘al’.

Gjatë vitit 2010 AKEP ka liberalizuar procedurat e dhënies së domain-ve edhe për personat natyrorë (individët) dhe ka ulur pagesën në 2 mijë lekë në 2 vjet për regjistrimin e domain-it.

Numri i domain-ve ka pësuar rritje të ndjeshme menjëherë me liberalizimin e këtij procesi.

Aktualisht janë të regjistruar 3200 domain të ndara sipas nën-domain-eve:

Domain	Nr. i domain-ve të regjistruar
.al	2480
.com.al	340
.gov.al	178
.org.al	98
.edu.al	81
.net.al	15
.mil.al	8
TOTAL	3200

Numri i domain-ve të regjistruar

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Suksesi i aksesit broadband në Internet është i lidhur ngushtësisht me infrastrukturën mbështetëse backbone, e cila mundëson transmetime të kapaciteteve të mëdha transmetuese të ndërtuara me fibra optike.

Për këtë është e nevojshme:

- Rritja e stimujve për investime në Infrastrukturën me Fibra Optike: urbane, ndërrurbane dhe lidhje ndërkombëtare;
- Përcaktimi i rregullave të qarta për “Right of Way” (E Drejta e kalimit);
 - Përcaktimi i kushteve teknike në projektimin e rrugëve për të parashikuar vendosjen e tubacioneve në rrugët e reja si dhe në rrugët ekzistuese;
 - Përdorimi i përbashkët i faciliteteve ose infrastrukturave si kulla, antena, ambiente teknike, tubacione etj.

AKEP është pjesëmarrës në grupin e punës të ngritur nga Qeveria për “Right of Way” si dhe në disa iniciativa të ministrive të linjës për dhënien me koncesion të infrastrukturave të ndryshme si rrjete elektrike, hekurudha për të mbështetur ndërtimin e rrjeteve kombëtare të fibrave optike.

Dhënia e Autorizimeve Individuale nga AKEP për brezat e frekuencave të teknologjisë së gjeneratës së tretë 3G/UMTS gjatë vitit 2010, do të mundësojnë futjen e teknologjive që ofrojnë internet pa tel me brez te gjerë.

Nertila Çaushi

Përgjegjëse

Departamenti i Hartimit të Akteve Ligjore

AKEP

Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) - një institutcion në zhvillim

- *Historik i shkurtër i QKR*
- *Çfarë është arritur deri tani*
- *Roli i QKR lidhur me procedurat e regjistrimit të biznesit*

QKR- një institucion në zhvillim

Një nga nismat e rëndësishme të ndërmarrë nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) është reforma e procedurave të regjistrimit të biznesit, e cila do të reduktojë në një ditë kohën e regjistrimit kërkuar për bizneset e reja dhe do të kombinojë në një procedurë të vetme, të gjithë hapat e regjistrimit – duke përfshirë regjistrimin për efekt të taksave. Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) është institucion i mbështetur nga Marrëveshja Prag e Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, administruar nga USAID.

Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) është një Institucion i orientuar drejt zhvillimit, që ofron shërbim të plotë dhe me një cilësi të lartë për subjektet tregtare, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Fokusi ynë është zbatimi rigoroz i procedurave administrative të regjistrimit të biznesit në shërbim të përmirësimit të vazhdueshëm të klimës së biznesit në vend. Ne jemi të bindur se japim kontributin thelbësor për operatorët ekonomikë. Qëllimi ynë është të ofrojmë një shërbim institucional të përgjegjshëm dhe të krijojmë një kulturë administrative tek biznesi.

Ne investojmë shumë në trajnimin e personelit tonë për të krijuar një mjedis pune të kënaqshëm dhe efikas, si dhe për t'u siguruar subjekteve

tregtare shërbimin më të mirë. Me punën e dedikuar dhe profesionale të stafit të këtij insitucioni ne kemi arritur nivelet më të larta të cilësisë, duke rritur çdo vit sasinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara. Të gjitha këto arritje nuk do të ishin të mundura pa përpjekjet dhe përkushtimin e këtij stafi. Kemi arritur të plotësojmë natyrshëm çdo kërkesë të të gjitha subjekteve tregtare me produktet që ne ofrojmë. Ne jemi të gatshëm t'u sigurojmë dhe garantojmë këtyre operatorëve ekonomikë besueshmëri, efektivitet, shpejtësi, siguri dhe orientim.

Përkushtimi ynë është të demonstrojmë perfeksionin në të gjitha sferat e punës sonë dhe në marrëdhëniet me operatorët ekonomikë, kolegët, partnerët, komunitetin. Për më tepër, ne mundohemi të shprehim në punën tonë profesionalizëm, rregull, disiplinë vetjake, këmbëngulje dhe shpirt pune në grup. Ne jemi insitucioni pararojë dhe gjithmonë pranë çdo biznesi, duke qenë të pranishëm në të gjithë Shqipërinë.

Tashmë QKR është një realitet në zhvillim, duke u shkëputur kështu, nga procedurat e zgjata burokratike gjyqësore dhe duke i shndërruar tërësisht regjistrimet dhe ndryshimet që pëson biznesi, në një procedurë administrative. Insitucioni ynë është pjesë e hapësirës europiane. Ne do të vazhdojmë të jemi gjithmonë pranë biznesit me cilësi, shërbim e shpejtësi në njësinë e kohës, sepse ne jemi “Imazhi udhërrëfyes për biznesin”.

Tomi Kola
Drejtor
QKR

Reforma e regjistrimit të biznesit: një përfitim i madh për bizneset në Shqipëri

Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) është krijuar dhe themeluar në bazë të Ligjit nr. 9723 datë 05.03.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si një Institucion i ri Publik në nivel qendror. QKR është institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri dhe funksionon në bazë të një sistemi elektronik të integruar të dhënash, që realizon lidhjen ndërmjet të gjitha sporteleve të shërbimit me selinë qendrore të QKR-së në Tiranë. Ai është ndërtuar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira për regjistrimin elektronik të biznesit, me mbështetjen e Marrëveshjes së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, administruar nga USAID. QKR e zhvillon aktivitetin e saj në 31 zyra sporteli në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke ofruar:

- Proces më të thjeshtë, më të shpejtë dhe me më pak shpenzime për regjistrimin e bizneseve të reja.

- Regjistrim të njëkohshëm në administratën e taksave, në sigurimet shoqërore, në sigurimet shëndetësore dhe në Inspektoriatin e Punës, nëpërmjet përdorimit të një procedure të vetme aplikimi.

- Sportele aplikimi për regjistrimin e biznesit në mbarë Shqipërinë, duke i mundur një biznesi, kryerjen e të gjithë procedurave të regjistrimit në nivel të qeverisë vendore;

- Qasje e lirë e publikut në informacionin e Regjistrimit Tregtar nëpërmjet Internetit.

Karakteristikat kryesore të QKR dhe të procedurave të reja të regjistrimit të biznesit janë:

1. Rrugëzgjdhja “one-stop-shop” për regjistrimin e biznesit. QKR ofron një zgjidhje “one-stop-shop” për regjistrimin e biznesit. Ky institucion shërben si sportel i vetëm për të gjitha llojet e entiteteve të biznesit në mbarë Shqipërinë, për të kryer dhe aplikuar për të gjitha proceset e regjistrimit të biznesit, duke përfshirë regjistrimin e taksave në nivel kombëtar dhe vendor (bashkiak), sigurimin shëndetësor dhe shoqëror, Inspektoriatin e Punës dhe Institutin Kombëtar të Statistikave.

2. Regjistrimi elektronik i biznesit. QKR ofron kapacitete maksimale për regjistrimin elektronik të bizneseve, si dhe qasje në informacionin e Regjistrisë Tregtarë përmes Internetit. QKR do të inkurajojë përdorimin e procedurave elektronike të regjistrimit përmes Internetit, ndërsa dokumentat jo-elektronike do të hidhen në bazën e të dhënave të QKR, për të lehtësuar procesin dhe për të mundësuar marrjen e informacionit nga publiku.

3. Regjistri tregtar elektronik: Regjistri Tregtar do të mbajë të dhënat për të gjitha tipet e entiteteve të biznesit dhe do të jetë një bazë të dhënash unike, e vetme dhe uniforme. QKR do t’ju ofrojë publikut, investitorëve të huaj dhe agjencive qeveritare qasje të plotë elektronike në informacionin e Regjistrisë Tregtarë.

4. Regjistrimi është i mundshëm në mbarë Shqipërinë. QKR, duke qenë një ent dhe bazë të dhënash unike dhe i centralizuar, ofron sportele

shërbimi në të gjithë vendin, duke funksionuar në zyrat e bashkive, të cilat do të jenë të lidhura me Regjistrin Tregtar të QKR-së. Kjo do t'i mundësojë bizneseve në të gjitha rajonet e vendit të përfitojnë nga shërbimet e regjistrimit të biznesit në një zyrë shumë pranë vendbanimit të tyre.

5. Plotësimi i standardeve ndërkombëtare për regjistrimin e biznesit: QKR dhe procedurat elektronike të tij do të bëjnë që Regjistri Tregtar shqiptar dhe regjistrimi i biznesit të përputhen plotësisht me të gjitha direktivat e zbatueshme të Bashkimit Europian. Ai do t'i bëjë regjistrimin e biznesit dhe informacionin e Regjistrimit Tregtar plotësisht të aksesueshëm për përdoruesit shqiptarë, si edhe për përdoruesit e huaj të biznesit.

6. Shumë përfitime për bizneset. Ligji i ri i propozuar për QKR e shndërron procesin e regjistrimit të biznesit nga një proces me shumë faza që kërkonte vendim-marrje ligjore nga gjykata, në një proces administrativ me një ndalesë. Procedurat e regjistrimit të QKR-së do ta thjeshtojnë dhe reduktojnë dukshëm koston e shërbimeve për regjistrimin e biznesit, duke reduktuar në një ditë të vetme periudhën e nevojshme për të regjistruar një biznes të ri dhe për të bërë ndryshime në informacionin për kompaninë e regjistruar. Liçensat që kërkohen për aktivitetet specifike do të merren në vijim, dhe nuk do të jenë më kusht që duhet përmbytur para regjistrimit të biznesit dhe regjistrimit tatimor. Të gjitha këto do të përmirësojnë dhe thjeshtojnë procedurat për regjistrimin e bizneseve dhe të sipërmarrësve të rinj.

Sipas ligjit të QKR-së ju mund të aplikoni për t'u regjistruar në QKR, në çdo sportel të saj në të gjithë Shqipërinë, pavarësisht vendodhjes së biznesit dhe vendbanimit tuaj.

Çfarë është arritur deri tani:

- **Ndërgjegjësimi i Publikut:**

QKR bën një punë intensive mbi informimin e publikut të gjerë në lidhje me legjislacionin tregtar në fuqi dhe ndryshimet përkatëse, kjo nëpërmjet manualeve, publikimeve, artikujve informuesë, buletineve dhe katalogëve të QKR-së, posterave apo afisheve të ndryshme dhe së fundmi, nëpërmjet reklamimit në masmedia. I është kushtuar rëndësi të gjithave sa më lartë, me qëllimin e familjarizimit të publikut operues me legjislacionin tregtar, për ta bërë edhe më të kuptueshëm perceptimin e tij nga ana e këtyre subjekteve tregtare, çka në vetvete, ka ndihmuar me përsheptimin e procesit të regjistrimeve pranë QKR-së.

- **Përmirësimi i afateve kohore dhe procedurave**

Përmirësimi i mëtejshëm i afateve kohore në lidhje me procedurat e subjekteve tregtare pranë QKR ka vijuar më tej me:

- Më datën 15.04.2009, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka nxjerrë Urdhrin Nr. 345 “Për regjistrimin dhe depozitimin e Bilancit vjetor kontabël”, në bazë të të cilit bilancet vjetore kontabël dhe raportet e auditimit tashmë depozitohen në QKR në format elektronik (CD, USB), ose çdo formë tjetër të ruajtjes elektronike, duke bërë të mundur reduktimin e kohës nga ana e subjekteve tregtare, si dhe ka shmangur në mënyrë konkrete radhët e gjata të paraqitjes së këtyre bilanceve, sidomos në periudhën e depozitimit të tyre.

- Aplikim i thjeshtëzuar – pa miratim nga sektori i regjistrimit për procedura si: depozitim bilanci, gjenerimi i ekstraktit të thjeshtë dhe atij historik, printimi i çertifikatave të regjistrimit, etj.

- **Rritja e standardeve të procedurave në QKR**


Periudha Janar-Qershor 2009 ka qënë për QKR-në, periudha e përshtatjes, rritjes, konsolidimit dhe zgjerimit të saj brenda territorit të Shqipërisë. Pavarësisht vështirësive dhe problematikës së shumëllojshme të tregut shqiptar, mungesës së eksperiencës apo edhe vetë rrisë së krijimit të saj, QKR-ja e arriti në mënyrë mjaft konkrete qëllimin e saj të përshtatjes, apo edhe adaptimit me këtë treg.

Arritja e këtyre standardeve fillestare e vendos QKR-në pranë sfidave të reja në prag të mijëvjeçarit të ri. Dëshira për të rritur, përmirësuar, orientuar dhe perfeksionuar sipas standardeve të Bashkimit Europian, janë disa nga objektivat e ardhshëm që do të synohen nga QKR-ja për këtë periudhë.


- **Përmirësimi i infrastrukturës**


QKR ka shënuar një progres solid në kompjuterizimin e të dhënave të bizneseve që kanë qënë të regjistruara, proces i cili po vazhdon së fundmi dhe me popullimin e të dhënave të këtyre bizneseve në rubrikat e formularëve të ekstrakteve historike të tyre.

Grafiku linear krahasues i Ndryshimeve për periudhën Janar- Shtator të vitit 2010



Grafiku linear krahasues i Regjistrimeve për periudhën Janar- Shtator të vitit 2010





Grafiku linear krahasues i Ndryshimeve për Person Fizik për muajin Gusht/ Shtator 2010 dhe Shtator 2009.

- **Studimi i tregut dhe faktorëve ndikues**

Anketimi i lançuar së fundmi në sportelet e QKR-së për subjektet tregtare që aplikojnë për çregjistrim si dhe anketimi për sugjerimet konkrete se ku duhet të konsistojë kategorizimi i paketave të ndihmës së Qeverisë ndaj strukturave të ndryshme, është një nga risitë e punës së QKR-së. Të dhënat i përcillen Ministrisë së Ekonomisë, në varësi të së cilës është edhe QKR-ja, duke ndihmuar në evidentimin e shkaqeve kryesore që ndikojnë dukshëm në çregjistrimin e subjekteve tregtare në Shqipëri. Qëllimi i këtij procesi është jo vetëm zbutjes së këtyre shkaqeve, por edhe me idenë e vënies në zbatim të politikave sociale të kësaj Ministrie, duke përmirësuar kështu klimën ekonomike në vend, si punësimin e forcave të lira, përmirësimin e mirëqenies sociale të popullsisë, në veçanti në zonat më të varfëra të vendit, uljen e informalitetit, i cili dëmton konkurrencën e ligjshme, etj.

- **QKR në vitet e ardhshme**

1 - Përmirësimi i imazhit të Shqipërisë duke ngritur standardet e shërbimit pranë QKR-së, ofrimit të produkteve të ndryshme nëpërmjet një shërbimi të një cilësie të lartë. Ky përmirësim i imazhit të vendit nëpërmjet shërbimit që ofron dhe përmirësimin të klimës së biznesit për të rritur atraktivitetin e vendit për subjektet e huaja, është fokusuar së fundmi edhe në aspektin social të:

- a. studimit të tregut;
- b. analizimit të vështirësive dhe problemeve të subjekteve tregtare
- c. analizimit të shkaqeve të çregjistrimit të subjekteve nga QKR, (kjo nëpërmjet anketimit që aplikohet në sportel, në momentin e

aplikimit për çregjistrim);

2- Ofrimi i transparencës, gjithëpërfshirjes dhe konsensus të të gjitha palëve të interesuara në proceset tregtare;

3- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit për përfitimet dhe mundësitë në tregti, nga zbatimi i standardeve teknike në shërbimet dhe produktet e tyre;

4- Krijimi i një klime pozitive për zhvillimin e biznesit dhe të veprimtarisë së subjekteve të huaja që operojnë në Shqipëri, e pasqyruar kjo në reduktimin e barrierave për investimet në Shqipëri dhe krijimit të lehtësirave për biznesin dhe subjektet e huaja;

5- Vendosja e marrëdhënieve afatgjata në lidhje me operatorët ekonomike që operojnë në Shqipëri;

6- Marrja e mendimit konkret dhe sugjerimet përkatëse mbi mënyrat e operimit të institucionit dhe aspektet e përmirësimit të mundshëm të punës së tij;

7- Ballafaqimi i legjislacionit ekzistues me nevojat reale të Komitetit të Licensimit, si edhe mbledhja e propozimeve për përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit;

8- Krijimi i procedurave standarde të operacioneve të bazuara mbi rastet precedente me qëllim unifikimin e logjikës juridike në interpretimin dhe zgjidhjen e rasteve problematike dhe atyre të paprecedent.

4. Perspektivat dhe Parashikimet për periudhën Qershor–Dhjetor 2009

Pavarësisht nga vështirësitë e hasura gjatë ecurisë së veprimtarisë së QKR-së, gjashtëmujori i dytë do të vazhdojë të jetë një periudhë mundësish dhe zhvillimi në të gjitha segmentet e veprimtarisë së QKR-së.

Rritja e pritshmërisë së numrit të subjekteve, zhvillimet rregullative, përparimet teknologjike dhe hyrja në zonat e reja të biznesit, të gjitha do të sigurojnë sfida dhe mundësi për QKR-në që të rrisë gamën dhe të përforcojë shërbimet ndaj të gjithë këtyre operatorëve.

Prioritetet

- *Harmonizimi dhe reformimi i legjislacionit shqiptar në përputhje me standardet e BE;*
- *Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së shërbimeve të QKR-së do të vazhdojë të jetë një prioritet i lartë.*
- *Zbatim i plotë në praktikë i legjislacionit të përafuar.*
- *Bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar dhe shkëmbimi i eksperiencës me institucionet homologe në rajon dhe më gjerë.*
- *Rritja e profesionalizmit, transparencës dhe mbajtja në nivelin zero të mundësisë për korrupsion, duke bërë të mundur zbatimin korrekt të ligjit në trajtimin e të gjithë kompleksitetit të çështjeve tregtare e afateve ligjore përkatëse.*

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Gentian Haxhiaj

Përgjegjës i Sektorit të Sportelit,
QKR

Cila ishte arsyeja e krijimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit?

Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) është krijuar në kuadrin e nismës së përbashkët të qeverisë shqiptare dhe USAID, e vënë në jetë në 3 shtator 2007. Ky institucion u krijua për t'i ardhur në ndihmë biznesit për procedurat e regjistrimit të tij, tepër të rënduara deri në atë kohë.

Çfarë lehtësirash ofron QKR sot për biznesin shqiptar, lidhur me procedurën e regjistrimit?

Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) u krijua si një sportel me një ndalesë, ku biznesi mund të regjistrohet për një sërë shërbimesh, gjë që më parë e kishte të pamundur. Biznesi më parë duhej të regjistrohej në gjykatë dhe më pas në organet tatimore, duke zgjatur kështu procedurat burokratike. Ndërsa me krijimin e QKR-së, biznesi tashmë mund të regjistrohet në të njëjtën kohë edhe on-line në regjistrin tregtar, organet tatimore, sigurimet shoqërore dhe zyrën e punës. Kjo procedurë zhvillohet brenda një periudhe kohore 24 orëshe dhe me një kosto prej vetëm 100 lekësh, duke shmangur në këtë mënyrë kostot financiare dhe procedurat e tejzgjatura.

A mund të na përmendni disa nga vështirësitë e fillimit të punës së këtij institucioni?

Sigurisht që fillimi i funksionimit të këtij institucioni nuk ka qenë aspak i lehtë, pasi sportelet e shërbimit ishin vetëm 4, ndërsa më vonë u shtuan sportelet si në qendër, ashtu edhe në rrethet kryesore më të mëdha. Sot QKR-ja numëron 76 sportele në 31 Bashki dhe Dhoma Tregtie. Gjithashtu, është shtuar dhe numri i shërbimeve krahasuar me atë të fillimit. Sfidat për të ardhmen janë të shumta, pasi QKR-ja në objektivat e saj ka shtimin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.



Shtrirja e sporteleve të QKR-së

Ilda KOJA

Përgjegjëse e Sektorit të Regjistrimit,
QKR

Çfarë risish solli krijimi i QKR-së në legjislacionin për regjistrimin e biznesit?

Me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 9723, datë 03.07.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, regjistri i shoqërive tregtare pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, regjistri i personave fizik pranë gjykatave përkatëse të rretheve së bashku me dokumentacionin shoqërues, u transferuan në administrim të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Nëpërmjet këtij ligji është arritur:

- Kalimi i procesit të regjistrimit nga një proces gjyqësor në një proces administrativ;
- përmirësimi dhe thjeshtimi i procedurave të regjistrimit;
- minimizimi i kohës dhe kostos së regjistrimit;
- mundësimi i kryerjes së regjistrimit në kushte më të përshtatshme dhe ofrimi i këtij shërbimi pranë zonave të banimit të operatorëve;
- regjistrim në të njëjtën kohë në organet tatimore, në skemën e sigurimeve shoqërore e shendetësore dhe pranë Inspektoriatit të punës, duke krijuar kështu një procedurë unike;
- garantimi i aksesit të plotë në të dhënat që regjistrohen për subjektet tregtare.

Ky ligj bëri të mundur aplikimin e një sistemi modern regjistrimi dhe përmirësoi klimën e të bërit biznes. Regjistrimi, përpunimi dhe

ruajtja e të dhënave, të njoftuara dhe të depozituara në regjistër, kryhet nëpërmjet një sistemi elektronik. Kjo ishte një nga arritjet më të rëndësishme të QKR-së dhe bëri të mundur kursimin e kohës dhe uljen e shpenzimeve si për përdoruesit publikë, ashtu edhe për ata private, rriti transparencën dhe besueshmërinë.

Ç'rol ka struktura përgjegjëse në QKR, për realizimin e procedurës së regjistrimit?

Një nga sektorët bazë të QKR-së, i cili është i përfshirë drejtpërdrejtë në procesin e regjistrimit, është sektori i regjistrimit, aktiviteti i të cilit realizohet nëpërmjet një stafi të kualifikuar të përbërë tashmë nga 13 juristë. Puna në këtë Sektor është bazuar kryesisht në këta elementë:

1. Ofrimi i shërbimeve funksionale në respektim të afateve ligjore (procesi i regjistrimeve);
2. Publikimi i të dhënave që regjistrohen dhe dokumenteve shoqëruese të subjekteve.
3. Ndërmarrja e iniciativave të tjera në funksion të realizimit të objektivave të QKR.
4. Ngritja e vazhdueshme profesionale e stafit të Sektorit të Regjistrimit nëpërmjet organizimit të trajnimeve.

Në këtë Institucion të gjithë sektorët bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme për të arritur objektivat e përbashkëta. Edhe në Sektorin e Regjistrimit, fryma e bashkëpunimit është tashmë e konsoliduar dhe ka arritur të krijojë një strukturë organizimi efikase, e cila ka përmirësuar dukshëm nivelin e performancës së stafit të këtij sektori.

Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) - tashmë një lehtësi për biznesin në Shqipëri

- *Procedura e licencimit*
- *Shkurtimi i kohës dhe kostos*
- *Regjistri Kombëtar i Lejeve dhe Licencave*

QKL, tashmë një lehtësim për biznesin në Shqipëri

QKL u ngrit me vendim të Këshillit të Ministrave në dhjetor 2008, si një institucion qendror publik në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe filloi të ofrojë shërbimet për bizneset më Qershor 2009. Duke shfrytëzuar zgjidhjet bashkëkohore që ofron teknologjia e informacionit, kjo Qendër funksionon në bazë të një sistemi elektronik, i cili automatizon procesin e licencimit dhe mundëson ndjekjen hap pas hapi të ecurisë së aplikimit. Me shërbimin me një ndalesë dhe me procedura të shkurtuara, transparente dhe të shpejta, QKL-ja redukton pengesat administrative ndaj nismës së lirë, ul kostot për bizneset në procesin e licensimit dhe zvogëlon hapësirat për informalitet, duke përmirësuar ndjeshëm klimën për biznes në Shqipëri.

Të nderuar lexues,

Materiali me të cilin do të njiheni në vijim ka të bëjë me një arritje tjetër të reformës rregullatore, atë në fushën lejeve dhe licencave, e cila në kuadër të qëllimit kryesor të kësaj reforme, krijimin e një klime më atraktive për të thithur investime, krijimin e një mekanizmi efikas kundër korrupsionit, dhe arritjen e një reputacioni më të mirë të vendit në tregjet rajonale dhe botërorë kulmoi në ngritjen dhe fillimin e funksionimit të Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL), e cila filloi të ofrojë shërbimet për bizneset më datë 9 Qershor 2009, si një institucion qendror publik në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Misioni i QKL-së, sikurse trajtohet dhe në këtë material, është lehtësimi i të bërit biznes në Shqipëri në funksion të zhvillimit të shpejtë e të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit tonë. Kjo strategji është lehtësisht e kuptueshme, duke iu referuar krahasimit që bëhet në këtë material mbi numrin e aktiviteteve që kanë patur nevojë për licencë/leje, si dhe procedurave para fillimit të funksionimit të QKL-së dhe të kategorive dhe procedurave aktuale.

Gjithashtu nëpërmjet kësaj përmbledhje, çdo lexues do të marrë një informacion mbi mënyrën e funksionimit të QKL-së, procedurat e trajtimit për çdo licencë/leje të nevojshme për ushtrimin e një aktiviteti apo përdorimi të mirë publike, garancinë për transparencë për çdo subjekt nëpërmjet një sistemi elektronik operimi të aksesueshëm nga të gjithë, kostot minimale të shërbimeve dhe mundësinë për t'u mirëpritur nga sportelet e shërbimit të QKL-së pothuajse në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Eneida Guria

Drejtoreshë e Përgjithshme
Qendra Kombëtare e Licencimit

QKL - tashmë një lehtësi për biznesin në Shqipëri

Morën fund terri informativ, endjet pa fund nga një zyrë në tjetrën, përgju me dokumente për t'u plotësuar dhe orët e gjata të harxhuara për të marrë një licencë, autorizim apo leje për biznesin tuaj! Licencimi/ lejimi apo autorizimi i një biznesi është tashmë një reformë e sukseshme dhe në funksionim të plotë me synimin për një përmirësim dhe zgjerim të mëtejshëm të kufijve të aplikimit sipas modelit të ri të licencimit. Duke u mbështetur në eksperiencën tashmë të konsoliduar të vendeve të zhvilluara dhe të inspiruar nga rezultatet e arritura në krijimin dhe përdorimin e “one stop shop” dhe/ose regjistrimit online të biznesit, të mbështetur nga avancimet e teknologjisë së informacionit, gjithnjë e më shumë vendet në zhvillim po përdorin me sukses one stop shop për të reduktuar barrierat administrative si dhe kostot, përfshirë këtu ato direkte dhe indirekte të të bërit biznes. Në vazhdimësi të objektivave të sukseshme të ndërmarra në këtë kuadër, reforma shënoi një arritje, fillimin e aplikimeve energjetike pranë QKL-së më datë 9 Qershor 2010, e cila përkoi saktësisht me një vjetorin e QKL-së. Ky Institucion është mbështetur nga Marrëveshja Prag e Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, administruar nga USAID.

Programi i Qeverisë, i materializuar tashmë edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, mundëson kështu një zhvillim të shpejtë e afatgjatë të vendit dhe një integrim të suksesshëm të tij.

QKL-ja, e krijuar si rezultat i reformës rregullatore në fushën lejeve dhe licencave synon një klimë më atraktive për të thithur investime, një perceptim më të ulët të korrupsionit dhe një reputacion më të mirë të vendit në tregjet rajonale dhe botërore.

Në kuadër të qëllimit kryesor të reformës mbi përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative ndaj nismës së lirë në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, ose përdorimin e të mirave publike, QKL-ja garanton njëkohësisht mbrojtjen e interesit publik në ushtrimin e këtyre veprimtarive dhe në përdorimin e të mirave publike.

Fokusi primar i krijimit të Qendrës Kombëtare të Licencimit ishte lehtësimi i të bërit biznes në Shqipëri, çka do të stimulonte rritjen e investimeve vendase dhe të huaja, duke sjellë gjithashtu përfitime dhe një efekt të fuqishëm në jetën e çdo individi.

Klimë e përshtatshme biznesi nuk do të thotë gjë tjetër veçse:

- Unifikim i terminologjisë në Legjislacionin Shqiptar nëpërmjet inkorporimit të koncepteve të reja në fushën e licencimit/lejimit/autorizimit;
- derregullimi nëpërmjet reduktimit të ndjeshëm të numrit të licencave/lejeve/autorizimeve;
- qartësim i procedurave specifike të licencimit/autorizimit/lejimit;
- deburokratizimi nëpërmjet zbatimit të parimit të miratimit në heshtje;

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

- teknologji e përparuar elektronike mbi bazën e së cilës funksionon e gjithë procedura e licencimit, e cila ka sjell reduktimin e numrit të hapave apo zyrave të përfshira në proces, si dhe shkurtim i ndjeshëm në afatet e përpunimit të kërkesave;
- respektimi i së drejtës themelore të komunitetit të biznesit mbi informimin intensiv të tij, çka sigurohet nëpërmjet transparencës maksimale dhe aksesit të plotë të publikut në Regjistrin Elektronik të lejeve dhe licencave;
- mospërcënimin e kompetencave të institucioneve të pavarura të njohura nga Kushtetuta dhe ligji;
- ofrimi i shërbimeve në pjesën më të madhe të territorit shqiptar nga një staf i kualifikuar, i cili i është nënshtruar rekrutimit kompetitiv, si dhe trajnimit intensiv.

Të gjitha sa më sipër, janë hapa të vëna tashmë në zbatim me sukses të plotë.

Nga 300 lloje e nënlloje leje/licenca përpara nisjes së kësaj reforme, numri i tyre është reduktuar në 65, 46 prej të cilave aktualisht shqyrtohen nga/ose nëpërmjet QKL-së.

Bazuar në legjislacionin e licencave, aktivitetet që meritojnë të licencohen nga/apo nëpërmjet QKL-së, u përkasin fushave respektive si: rendi dhe civile, arsimit, drejtësia, ushqimi dhe shëndeti, mjedisi, transporti, çështje sociale dhe punësimi, miniera dhe energji, industri dhe shërbime të tjera.

Për t'u ardhur akoma edhe më shumë në ndihmë bizneseve, QKL-ja bazuar në nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me QKR-në, e cila daton më 14.12.2009, përveç 8 sporteleve në Tiranë hap sportelet e saj të shërbimit në qytetet e Korçës, Shkodrës, Vlorës, Elbasanit, Peshkopisë, Durrësit, Fierit, Beratit dhe Gjirokastrës.

Procedura e licencimit

Referuar parimeve të përgjithshme të procedurave të licencimit licencat/lejet që shqyrtohen nga ose nëpërmjet QKL-se ndahen më tej në 3 grupe:

Grupi i parë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat vlerësimi i përmbushjes së kriterëve bazohet vetëm në vetëdeklarimet e kërkuarit.

Grupi i dytë përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat vlerësimi i përmbushjes së kriterëve, përveçse në vetëdeklarimet e kërkuarit, bazohet, për të paktën njërin nga kushtet, edhe në dokumentet provuese, të paraqitura nga kërkuari.

Grupi i tretë përfshin ato kategori që krahas karakteristikës që kanë sipas grupit të dytë, shqyrtimi i ligjshmërisë dhe/ose meritës së kërkesës së subjektit bazohet në përdorimin e metodave të tjera si inspektim, testim, provim, garë, intervistë, dëgjim publik apo çdo metodë tjetër e përshtatshme dhe e përcaktuar nga ligji apo aktet nën/ligjore.

Grupi i parë dhe i dytë trajtohet ekskluzivisht nga QKL, e cila në këtë rast shfaqet me të gjitha tiparet e një qendre të vetme me një ndalesë. Procedura për këto dy grupe është mjaft e thjeshtë, bazuar në forma e formate standarde të bërjes së kërkesës, në dokumente të mirënjohura për t'u paraqitur dhe në një shqyrtim të shpejtë nga QKL. Në rastin e grupit të parë procedura zgjat maksimalisht dy ditë pune, ndërsa në grupin e dytë ajo zgjat maksimalisht 4 ditë. Në fakt kjo është plotësisht realiste për shkak të thjeshtësisë dhe standardizimit të informacionit që shqyrtohet për çdo kërkesë.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Ndërkohë, për licencat e grupit të tretë ndiqet një procedurë e ndryshme nga ajo për dy grupet e para. Pas marrjes së aplikimit, QKL-ja vlerëson vetëm përmbushjen e kritereve në kompetencë të saj, bazuar në vetëdeklarimin e kërkuarit dhe/apo dokumentet provuese, sipas të njëjtave procedura dhe afate për licencat e grupit të parë dhe të dytë. Në rast se këto kritere përmbushen, atëherë aplikimi i përcillet në mënyrë elektronike institucionit tjetër përgjegjës për vendimmarrjen.

Në bazë të VKM Nr.1295, date 29.12.2009 “Për disa ndryshime në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, afati në dispozicion të këtyre institucioneve për vendimmarrjen është reduktuar, me qëllim lehtësimin akoma edhe më shumë të procedurave të licencimit.

Koha dhe kostoja

Mosmarrja e vendimit brenda afateve të përcaktuara të vendimmarrjes konsiderohet miratim në heshtje dhe subjekti gëzon të drejtën e përfitimit të titullit të licencës.

Koha dhe kostoja për marrjen e një licence ndryshon në bazë të grupeve të sipërpërmendura. Kostoja për marrjen e një licence që i përket grupit të parë ose grupit të dytë është vetëm 100 lekë, e cila përkon me tarifën e QKL-së

Kostoja për marrjen e një licence të grupit të dytë përfshin tarifën e aplikimit të QKL, si dhe tarifën sektoriale, e cila është e përcaktuar nga legjislacioni sektorial. Në këtë rast, aplikanti ka një muaj kohë për të

paguar tarifën sektoriale dhe, nëse pas një muaji nuk është bërë pagesa, licenca e dhënë revokohet.

e-Gov – Regjistri Kombëtar i Lejeve dhe Licencave

E gjithë procedura e licencimit bazohet në një sistem të integruar elektronik, i cili përbën dhe çelësin kryesor të këtij suksesi. Krijimi i Regjistrit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave përbën mjetin nëpërmjet të cilit mundësohet bërja e kërkesave, shqyrtimi i tyre nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) dhe Institucionet e tjera Qendrore, e deri tek lëshimi apo revokimi i tyre. Regjistri duhet kuptuar si një rrjet komunikimi zyrtar i aksesueshëm nga aplikantët dhe publiku përgjatë procedurës, si arkivë zyrtare elektronike e akteve dhe botimin zyrtar elektronik, i cili shërben për të shpallur aktet, të cilat hyjnë në fuqi vetëm nëpërmjet kësaj shpalljeje.

Me qëllim që të shmanget çdo cënim, sado i vogël i pavarësisë së Institucioneve të pavarura qoftë edhe si keqkuptim, si dhe duke konsideruar volumin e madh të informacionit që qarkullon dhe ruhet në regjistër, ai është konceptuar si një rrjet, në të cilin çdo institucion ka pjesën e tij në të cilën boton kërkesat, projektaktet apo aktet që janë të detyrueshme të botohen në regjistër, si dhe informacione të tjera të dobishme.


Organizimi i Regjistrit në tre nënregjistra, ai i nismave ligjore dhe nënligjore, i informimit mbi rregullat për licencat, lejet dhe autorizimet, si dhe ai aplikativ për licenca dhe leje përcakton edhe rolet tematike të këtij regjistri.

Regjistri elektronik është një instrument që siguron transparencën maksimale të procedurës vendimmarrëse si dhe lehtësimin maksimal

të kësaj procedure. Ai mundëson përdorimin e parimit të “miratimit në heshtje” duke i dhënë mundësinë çdo subjekti të informohet mbi licencat dhe lejet e zotëruara nga çdo subjekt.

Nga të dhënat e fundit statistikore, të reflektuara këto në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, rezulton se fluksi i aplikimeve është në rritje dhe numri i kërkesave për aplikim që nga fillimi i funksionimit të QKL-së ka arritur në rreth 3000 aplikime, çka bën të qartë jo vetëm numrin e konsiderueshëm të kërkesave të subjekteve për aplikim, por e përkthyer në terma më të thjeshtë nënkupton rritjen e investimeve vendase dhe të huaja.

Sistemi i ri i licencave e lejeve dhe vetë Qendra Kombëtare e Licencimit janë të afta t’u përshtaten modifikimeve të nevojshme që do pësojë mjedisi rregullator. Ndërkaq, QKL-ja do forcojë kapacitet e saj për të bërë oponencën e çdo ndryshimi që do t’i propozohet këtij sistemi



nëpërmjet përdorimit të metodës së Vlerësimit të Efektit të Rregullave, me qëllim që sistemi i licencave e lejeve, të ruajë tiparet aktuale të thjeshtësisë, lehtësisë dhe kostos minimale për bizneset.

Sporteli energjetik

Në vazhdimësi të objektivave të suksesshme të ndërmarra në këtë kuadër, reforma rregullatore shënoi arritjen e radhës, fillimin e aplikimeve energjetike pranë QKL-së më datë 9 Qershor 2010, e cila përkon saktësisht me 1 vjetorin e QKL-së.

Në bazë dhe zbatim të VKM Nr. 385, datë 19/05/2010, “Për licencimin e projekteve energjetike” faza e parë nënkupton që QKL pranon kërkesat, trajton, lehtëson, koordinon dhe monitoron procesin e lëshimit të licencave, lejeve, autorizimeve, certifikimeve dhe akteve të tjera administrative në sektorin energjetik në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Regjimi administrativ i aplikuar është ruajtur po i njëjti, por ndërkaq, QKL shndërrohet në një pikë fokale lidhur me çdo kërkesë. Në këtë mënyrë mundësohet mbajtja e një regjistri të veçantë për çdo projekt energjetik duke bërë të mundur ndjekjen nga ana e QKL-së të ecurisë së procedurave për çdo projekt të këtij lloji.

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, QKL ka patur një bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, MCCA2 (Programi Prag i Koorporates së Sfidës së Mijëvjecarit për Shqipërinë II), i cili reflektohet në realizimet e përmendura më lart.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

Si rezultat i këtyre bashkëpunimeve dhe arritjeve, sistemi i ri i licencave e lejeve dhe vetë Qendra Kombëtare e Licencimit kanë fituar fleksibilitetin për t'iu përshtatur modifikimeve të nevojshme që do pësojë mjedisi rregullator. Ndërkaq, QKL-ja do të forcojë kapacitetet e saj për të bërë oponencën e çdo ndryshimi që do t'i propozohet këtij sistemi nëpërmjet përdorimit të metodës së Vlerësimit të Efektit të Rregullave me qëllim që sistemi i licencave e lejeve të ruajë tiparet aktuale të thjeshtësisë, lehtësisë dhe kostos minimale për bizneset.

E- Qeverisja nga koncept në realitet

- *Roli i TIK për mirëqeverisjen*
- *E-Qeverisja dhe ndërveprimi me qytetarët*
- *Drejtimit strategjike për zhvillimin e qeverisjes elektronike*
- *Matja e qeverisjes elektronike*

E-Qeverisja nga koncept në realitet

Genc Radovicka

Drejtor i Koordinimit të Projekteve dhe Platformës e-Gov
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Irena Malolli

Drejtor i Strategjisë dhe Plan Veprimit
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e qëllimit strategjik për një qeverisje gjithmonë edhe më të mirë. Nëpërmjet TIK sigurohet qeverisja elektronike (e-qeverisja), e cila nuk është gjë tjetër, veçse një instrument për një qeverisje më efektive më efçente dhe më transparente. Sot, dobia kryesore e sistemeve teknologjike të qeverisjes elektronike shihet në ndërtimin e një shoqërie informacioni të hapur nëpërmjet ofrimit të një morie të gjerë të shërbimeve publike on-line, duke nxitur partneritete të ndërsjella publike dhe private me përfitime të qarta ekonomike, në rritjen e demokracisë përfaqësuese dhe veçanërisht në praktikën dhe modelet qeverisëse aktuale, të cilat po ndryshojnë rrënjësisht.

E-Qeverisja është një instrument i një shoqërie informacioni në formën e parimeve qeverisëse, strategjive, sistemeve dhe mjeteve që mundësojnë përdorimin e TIK në ndërveprimet reciproke ndërmjet elementëve kyç të shoqërisë (shteti, qytetarët, dhe bizneset) për të forcuar

demokracinë dhe mbështetur zhvillimin. E-Qeverisja nuk është thjeshtë një çështje e pajisjes me kompjuter të nëpunësve të administratës shtetërore apo automatizimi i praktikave të punës. Fokusimi vetëm në zgjidhje teknologjike nuk do të ndryshonte mentalitetin e burokratëve që nuk e shohin qytetarin as si një klient i qeverisë, as si një pjesëmarrës në vendimmarrje. E-Qeverisja përdor teknologjinë për kryerjen e reformave duke kultivuar transparencë, eliminuar distancën dhe ndarjet e tjera, dhe duke u mundësuar qytetarëve që të jenë pjesëmarrës në proceset politike që ndikojnë në jetën e tyre.

Si përfundim mund të themi se e-Qeverisja ka të bëjë me transformimin e mënyrës së ndërveprimit të qeverisë me qytetarët dhe, nëse mbështeten siç duhet, kthehet në një faktor të rëndësishëm të proceseve të zhvillimit, veçanërisht në drejtimet të tilla si:

I. Drejtim dhe Qeverisje, nëpërmjet mundësimit të sistemeve më eficiente manaxhimi dhe shërbimesh, duke rritur transparencën dhe duke mbështetur proceset e decentralizimit, si dhe rritjes së rolit të qytetarëve e pjesëmarrjes së tyre në proceset demokratike;

II. Zhvillim ekonomik, duke përmirësuar (shkurtuar dhe lehtësuar) procedurat për shërbime ndaj biznesit, informacion më të shpejtë dhe më të saktë në lidhje me tregjet, prodhimet, kërkesat etj.

III. Rritje të nivelit të shërbimeve bazë, kryesisht të shërbimit shëndetësor (telemjekësia dhe sistemet e paralajmërimit për epidemitë), arsimin (arsimimin në distancë), duke lehtësuar shkëmbimin interaktiv dhe përhapjen e informacionit e njohurive, duke mbështetur përpjekjet koordinuese në nivel lokal, rajonal dhe global.

IV. Reduktim të varfërisë, duke përmirësuar sistemet e ndihmave ekonomike, duke lehtësuar përfshirjen sociale, aksesin në informacion dhe shkëmbimin e tij, deri në zonat më të largëta dhe ndërmjet grupeve më pak të favorizuara.

V. Menaxhim të ambientit dhe territorit, nëpërmjet përdorimit të Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS), i cili nga ana e tij kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës, sigurimit të ushqimeve, etj.

VI. Planifikim të zhvillimit rajonal, duke mundësuar “rrjedhën apo fluksin” e informacionit pa u penguar nga barrierat gjeografike, si dhe duke lehtësuar riintegrimin ekonomik, shërbim më të mirë administrativ, e menaxhimin e lëvizjeve të popullsisë.

Modeli i sotëm i zhvillimit të e-qeverisjes përfshin jo vetëm përdorimin e teknologjisë së informacionit për të automatizuar proceset e brendshme të punës së qeverisë, por edhe përdorimin e kësaj teknologjie për të mbështetur dhe transformuar mënyrën e komunikimit e të bashkëpunimit të qeverisë me pjesën e jashtme. Përdorimi i këtij modeli mundëson vendosjen e sistemeve të informacionit në zemër të reformave ekonomiko-sociale dhe zgjeron fokusin nga thjesht e-administratë, duke përfshirë në to edhe e-shtetasin, e-shërbimet dhe e-shoqërinë. Në praktikë, kjo do të thotë:

- Një rol qendror për TIK: ku e-qeverisja bëhet gjithnjë e më shumë intensive nga pikëpamja e informacionit dhe TIK bëhet një pjesë e domosdoshme e iniciativave qeverisese. Si rezultat, TIK shndërrohet në një çelës për ndryshim.

- Një rol integrues për TIK: ku e-qeverisje do të thotë përdorimi i TIK si një instrument për qeverisje të mirë. TIK nuk është më një mekanizëm në vetvete, por vetëm si një pjesë e paketës së punës dhe veprimtarisë së qeverisë.

E-Qeverisja

E-Qeverisja siguron tre ndryshime potenciale për qeverisje të mirë:

Automatizim: zëvendësimin e proceseve të kryera nga njeriu si pritja, ruajtja, përpunimi, nxjerrja dhe transmetimi i informacionit.

Informatizim: mbështetje të proceseve informative të kryera nga njeriu si vendimmarrja, komunikimi dhe zbatimi i vendimeve.

Transformim: krijim të proceseve të reja informative duke përdorur TIK ose duke mbështetur proceset e reja, si krijimi i mënyrave të reja të ofrimit të shërbimeve publike

Këto ndryshime potenciale mund të sjellin, në mënyrë të vetme ose në kombinim midis tyre, përfitimet e mëposhtme kryesore për një qeverisje më eficiente dhe më efektive:

I. Qeverisje më të lirë: duke dhënë të njëjtin rezultat me një kosto totale më të ulët.

II. Qeverisje që bën më shumë: duke dhënë më shumë rezultate me të njëjtën kosto totale.

III. Qeverisje më të shpejtë: duke dhënë të njëjtat rezultate me të njëjtën kosto totale në më pak kohë.

IV. Qeverisje që funksionon më mirë: duke dhënë të njëjtat rezultate, me të njëjtën kosto totale, në të njëjtën kohë, por me standarde cilësie më të larta.

V. Qeverisje novatore: duke dhënë rezultate të reja.

Tre janë drejtimit kryesore të e-qeverisjes, përmirësimi i proceseve të qeverisjes: **e-administrata**, lidhja e shtetasve/bizneseve: **e-shërbimet**, Ndërtimi i ndërveprimit me dhe brenda shoqërisë civile: **e-shoqëria**.

Qeveritë përdorin strategji të ndryshme për ndërtimin e qeverisjes

elektronike. Disa kanë hartuar plane afatgjata gjithëpërfshirëse. Të tjera kanë zgjedhur të identifikojnë vetëm disa fusha bazë, si fokus për projektet e para.

Roli i Qeverisë

Suksesi i qeverisjes-elektronike kërkon ndryshimin rrënjësor të mënyrës se si qeveria punon dhe se si e shohin qytetarët ndihmën e qeverisë. Tri janë përgjegjësitë bazë që qeveria duhet të pranojë për implementimin me sukses të TIK:

Qeveria si një rregullator. Si rregullator kombëtar, qeveria është përgjegjëse për vendosjen e rregullave kombëtare për përdorimin e teknologjisë, ku përfshihen:


Qeveria si një lehtësues. Si një lehtësues, qeveria mund të kërkojë stimulimin e përdorimit dhe aksesimit të TIK nga qytetarët. Ajo mund të nxisë zhvillimin e sektorit privat duke ofruar ndihmë dhe hequr pengesat për progresin.

Qeveria si një përdorues i gjerë i TIK. Si një përdorues i gjerë i TIK, shpesh më i madhi, qeveria duhet të kërkojë të përdorë TIK për ofrimin me kosto efektive shërbimet dhe informacionin tek qytetarët dhe punën efektive të administratës qeveritare. Si një blerës kryesor i pajisjeve dhe shërbimeve të TIK, ajo gjithashtu mund të influencojë tregun nëpërmjet përdorimit për shembull, të fuqisë së saj blerëse për zhvillimin e një industrie kombëtare të TIK.

Administrimi i centralizuar/decentralizuar i infrastrukturës

Në drejtim të administrimit të infrastrukturës, mbi të cilën zhvillohet e-Qeverisja praktikisht egzistojnë tri zgjidhje të mundshme, të cilat janë:

I. **Administrim i Centralizuar:** sistemi i administrimit është i përqëndruar në nivelin më të lartë qendror. Përdorimi i një zgjidhje të tillë sjell përfitime në efikasitet të përdorimit të burimeve njerëzore dhe administruese. Zbatimi i sistemeve të informacionit duke adoptuar zgjidhjen e centralizuar ka ardhur kryesisht nga nevoja për të kontrolluar kostot, pasojat, dështimet e mundshme dhe kryesisht nga nevoja për të arritur objektiva të rëndësishëm. Anëtarë pozitivë të kësaj zgjidhjeje janë bashkëpërdorimi i burimeve, shmangja e duplikimeve të burimeve njerëzore, fitimi i eksperiencës dhe kontrollit, ndërtimi i sistemeve me kosto të ulët, etj. Por, në të njëjtën kohë bazohet në zgjidhjeje si të përceptimit, teknologjisë dhe burimeve, ashtu edhe në pikëpamje të pengesave institucionale, politike, kulturore dhe administrative.



II. **Administrim i Decentralizuar:** sistemi i administrimit është i shpërndarë në nivelet më të ulëta, praktikisht është një administrim individual në njësitë e administratës publike. Përdorimi i një zgjidhjeje të tillë mundëson shpërndarjen e burimeve dhe mundësive përpunuese të informacionit në gjithë organizimin qeveritar. Kjo metodë bazuar në

faktin se teknologjia po bëhet gjithnjë më e thjeshtë, më e lirë, më e lehtë për t'u përdorur, më e sigurtë, më e besueshme dhe më e fuqishme, duke ofruar më shumë mundësi për të aplikuar zgjidhje të decentralizuara, ka avantazhet si përputhje më të mirë ndërmjet sistemeve dhe nevojave lokale, përdorim më të madh të sistemeve kompjuterike, zhvillim më të shpejtë të sistemeve. Nga ana tjetër kjo zgjidhje ka disavantazhet e veta si barriera në ndarjen e informacioneve, barriera në përdorimin e përbashkët të burimeve njerëzore, dublikim të përpjekjeve, të nevojës për ekspertizë, të kontrollit, mungesë mundësie për të patur çmime speciale të ulta.

III. **Administrim Qendër-Periferi:** sistemi i administrimit është i ndërtuar në nivelin qendror me shpërndarje të burimeve dhe të mundësive përpunuese edhe në nivele më të ulta të veçanta. Një infrastrukturë e administruar sipas një kombinimi të veprimeve qendrore dhe atyre lokale është shumë efektive. Kjo zgjidhje tenton të kombinojë shtyrjen e zgjidhjes së centralizuar drejt periferisë me tërheqjen e zgjidhjes së decentralizuar drejt qendrës.

Drejtimet strategjike për zhvillimin e qeverisjes elektronike

Drejtimet bazë për zhvillimin e e-Qeverisjes mund të përmbliken si më poshtë:

e-Qeverisja e ndërtuar rreth përdoruesit. Zhvillimi i e-Qeverisjes duhet të plotësojë nevojat reale të përdoruesve; ku me konceptin përdorues përfaqësohen tre grupe: shtetasish, të cilët kërkojnë shërbime të e-Qeverisjes, entitetet legale ku përfshihen biznese dhe organizatat


jofitimprurëse (OJF-të) si dhe punonjësit e administratës publike.

One-Stop Shop. Zhvillimi i e-Qeverisjes duhet të drejtohet në drejtim të kombinimit të informacionit, burimeve administrative të informimit dhe e-shërbimeve, në një pikë shërbimi të përqendruar – Portali Shtetëror. Kjo pikë qendrore siguron drejtimin (rrugë-kalimin) e çdo përdoruesi drejt çdo situatë apo gjithshkaje, të cilën e ofron administratë publike. Gjithashtu sigurohet pika e vetme e hyrjes në shërbime, identifikimit dhe autentifikimit.

Thjeshtësia. Informacioni dhe e-shërbimet duhet t'i ofrohen përdoruesit në pikën e përbashkët të hyrjes në formë të thjeshtë dhe të kuptueshme, me qëllim që t'i garantojë përdoruesve përdorim të vlefshëm të kohës së tyre të harxhuar në Portalin Shtetëror. Thjeshtësia duhet të sigurohet gjithashtu edhe në anën e marrjes së informacionit nga përdoruesi për të aktivizuar një shërbim (p.sh. gjatë plotësimit të një forme aplikimi) duke përdorur sa më shumë informacion të brendshëm të sistemeve.

Standardizim. Administrata publike duhet të funksionojë si një mekanizëm i mirë koordinuar si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Nëpërmjet standardizimit i sigurohet përdoruesit përdorim të së drejtës së tij me të njëjtën cilësi, shpejtësi dhe nëpërmjet të njëjtit mjet, pavarësisht se kush është përgjegjës për ofrimin e shërbimit qeveria apo bashkia. Aktiviteti i qeverisë në këtë pikë, është inkurajimi i zgjidhjeve të e-qeverisjes edhe në nivel lokal.

Cilësor. Informacioni i marrë nga Portali Shtetëror duhet qeveria të jetë i një cilësie të lartë dhe i besueshëm. Cilësia e një e-shërbimi duhet gjithashtu të sigurohet nga një përgjigje e saktë dhe cilësore, në formë standarde, zyrtare dhe e garantuar.



Transparente. Duke u bazuar në përdorimin e teknologjive më të përparuara të TIK e-Qeverisja duhet të sigurojë realizimin e procedurave transparente dhe të monitorueshme. Nëpërmjet transparencës duhet të sigurohet mundësia për të pasur informacion për gjendjen aktuale të një kërkesë si edhe për kërkesa të mëparshme të arkivuara.

E sigurtë. Rritja dhe garantimi i vazhdueshëm i sigurisë, kurdo që është e nevojshme, duhet të jetë në vëmendje të vazhdueshme të e-Qeverisjes. Siguria e të dhënave personale apo të dhënave të tjera, sikurse përcaktohet në legjislacion, si dhe siguria e transaksioneve duhet të garantohet në të gjitha nivelet (shërbimet, infrastrukturë, rekorde, etj.). Përdorimi i vazhdueshëm i politikave të sigurisë rrit besueshmërinë e përdoruesve në e-Qeverisje.

Kudo dhe në cdo kohë. Një avantazh i rëndësishëm i e-Qeverisjes, është që shërbimet e saj ofrohen në çdo orë të ditës dhe në çdo ditë të vitit. Përdoruesi zgjedh kohën e tij më të përshtatshëm për të përdorur e-Qeverisjen duke përdorur kohën e tyre në mënyrë më racionale. Gjithashtu sot përdorimi i e-Qeverisjes mund të realizohet nga më shumë se një pajisje (Kompjuter, Service kiosk, celularë, etj.)

E shpejtë, efektive dhe e lirë. E-Qeverisja, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përparuar të informacionit dhe telekomunikacionit dhe zgjidhje organizative, mundëson ofrimin e shpejtë të shërbimeve dhe informacioneve. Funksionimi më efikas i administratës mundëson ofrimin e shërbimeve dhe informacioneve me kosto më të lirë për përdoruesit e shërbimeve dhe informacioneve të marra në format klasike ose për të njëjtin çmim përdoruesit marrin një shërbim më të shpejtë dhe cilësor.

I personalizuar dhe i përshtatshëm për të gjithë. Sipas kërkesave të përdoruesve, e-Qeverisja duhet të jetë e përshtatshme sipas nevojave personale të tyre, stilit të jetës dhe ngjarjeve të jetës së tyre. e-Qeverisja duhet të ofrojë informacion dhe e-shërbime të personalizuar sipas përdoruesve; si edhe duhet të ofrojë njoftime individuale rreth çështjeve të rëndësishme për përdoruesit.

Njohuri dhe trajnim. Trajnimi i përdoruesve të e-Qeverisjes është një hap i rëndësishëm në drejtim të ndërtimit të një sistemi e-Qeverisje të suksesshëm dhe eficient. Për këtë qëllim kurse dhe conference on-line si edhe mënyrat klasike të trainimit duhet jenë vazhdimisht të vlefshme për përdoruesit.

Pjesëmarrja në vendimmarrje – e-Demokracia. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i e-Qeverisjes është edhe marrja parasysh e nevojave dhe dëshirave të shtetasve, organizatave jo qeveritare dhe institucioneve të tjera dhe përfshirja e tyre në e-Qeverisje. e-Qeverisja duhet të ofrojë një ndërfaqe unike interaktive për shkëmbimin e e-opinioneve dhe sygjerime, nëpërmjet përdorimit të e-conferencave, faqeve web tematike, e-forumeve, e-votimi, e-chat-room dhe e-peticioneve. Të gjitha këto do ta bëjnë të aftë që në të ardhmen e afërt të ofrohet mundësia e e-referendumeve dhe e-zgjedhjeve.

Matja e Qeverisjes Elektronike

Metodologjia e matjes së indikatorëve ka për qëllim të përcaktojë nivelin e zhvillimit të e-shërbimeve për shtetasit dhe bizneset. Seicili prej e-shërbimeve, në momentin e matjes ka një nivel të caktuar zhvillimi, i cili quhet niveli i momentit. Gjithashtu çdo e-shërbim ka edhe një nivel maksimal të përcaktuar, i cili për kohë të gjatë nuk ndryshon. Deri vonë vlerësimi i zhvillimit të qeverisjes elektronike bëhet mbi bazën e modelit me katër nivele si më poshtë:

Niveli 0 – Nuk kemi faqe web/ose në website nuk ka asnjë informacion në lidhje me shërbimin në Internet


Niveli 1 – Ofrohet informacion nëpërmjet faqes web për fillimin e procedurës për marrjen e shërbimit (legjislacioni, rregullat, procedurat)

Niveli 2 – Jepet mundësia e shkarkimit të formularëve dhe përftimi në formë të printueshme për fillimin e një procedure për marrjen e shërbimit


Niveli 3 – Jepet mundësia e plotesimit të formularëve në rrugë elektronike

Niveli 4 – Trajtimi i aplikimit bëhet plotësisht elektronikisht

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II



Zhvillimi i sistemeve të informacionit, realizimi i integritimit dhe ndërveprimit të tyre kanë çuar dhe në zhvillimin e niveleve të ofrimit të shërbimeve nëpërmjet Internetit. Kështu sot, në vendet e BE-se, punohet me modelin me pesë nivele zhvillimi. Niveli i pestë i quajtur targetizim, është duke u zhvilluar për një pjesë të mirë të shërbimeve dhe lidhet me ofrimin e shërbimeve të personalizuara mbi bazën e sistemeve të ndërveprueshme. Ky model paraqitet në figurën e mëposhtme:



Po cilat janë shërbimet ku mbështetet dhe matja e qeverisjes elektronike? Nga Bashkimi Europian janë përcaktuar 20 shërbimet bazë të qeverisjes elektronike, të grupuara në shërbime Qeveri-Qytetarë (G2C), shërbime Qeveri – Biznes (G2B). Në listën e mëposhtme jepen 20 shërbimet bazë dhe niveli maksimal i zhvillimit/sofistikimit të tyre sipas modelit me katër nivele të zhvillimit si dhe niveli i ri maksimal i propozuar në dokumentin “Web-based Benchmark on electronic Public Services” (version 2.0) .

Shërbimet publike për qytetarët	Niveli maksimal	Niveli i ri maksimal*	Shënime Mbi modelin e ri të BE
Taksat mbi të ardhurat	(4)	(5)	Një nivel tjetër shtesë
Shërbimet e kërkimit për punë	(3/4)	(4)	
Përfitimet mbi sigurimet shoqërore	(4)	(5)	Një nivel tjetër shtesë
Dokumenta personale (pashaporta/patenta)	(3)	(5)	Niveli i (4) dhe (5)
Regjistrimi i makinave	(4)	(4)	Niveli (4) i rishikuar
Aplikimi për leje ndërtimi	(4)	(4)	
Deklarimi në polici	(3)	(3)	
Biblotekat publike	(3/4)	(4)	
Certifikatat	(3)	(4)	Një nivel tjetër shtese

Tabela 1: Niveli i zhvillimit /sofistikimit i shërbimeve për qytetarët

Shërbimet publike për biznesin	Niveli maksimal	Niveli i ri maksimal*	Shënime
Kontributi shoqëror për punonjësit	(4)	(4)	
Taksat për korporatat	(4)	(4)	
TVSH	(4)	(4)	
Regjistrimi i një kompanie të re	(4)	(4)	
Paraqitja e të dhënave në zyrat e statistikave	(3)	(5)	Shtuar Niveli (4), (5)
Deklarimet doganore	(4)	(4)	
Lejet e lidhura me mjedisin	(4)	(5)	Një nivel tjetër shtesë
Prokurimi public	(4)	(4)	

Tabela 2: Niveli i zhvillimit /sofistikimit i shërbimeve për biznesin

Situata aktuale në Shqipëri në drejtim të zhvillimit të e-Qeverisë

Qeveria ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale për shoqërinë e Informacionit, me VKM nr. 59 datë 21.1.2009. Zhvillimi i qeverisjes elektronike është pjesë integrale e këtij dokumenti strategjik.

Në këtë dokument është përcaktur si objektiv kalimi nga fazat e para të ofrimit të shërbimeve, pra nga dhënie informacioni nëpërmjet faqeve web, në nivelet e zhvilluara të ofrimit të shërbimeve në mënyrë interaktive dy drejtimshme. Ofrimi i shërbimeve moderne, lehtësisht të arritshme dhe plotësisht interaktive është synimi afatgjatë për qeverisjen elektronike. Kuptohet që realizimi i këtij synimi, kërkon angazhimin e të gjitha strukturave dhe institucioneve që janë ofruese të shërbimeve publike. Qeveria shqiptare në kuadrin e përmirësimit të shërbimeve qeverisëse ndaj qytetarëve, bizneseve si dhe përmirësimit të punës në administratë, ka implementuar dhe vazhdon të implementojë projekte të rëndësishme në fushën e e-Qeverisjes. Këto shërbime ndahen në tre grupe të mëdha:

- Shërbime ndaj qytetarëve G2C (Government to Citizen). Sot në grupin e shërbimeve ndaj qytetarëve situata paraqitet kryesisht në nivelin e shpërndarjes së informacionit, por shumë projekte janë në procesin e implementimit. Një nga shërbimet kryesore, i cili do të jetë shumë shpejt operativ është ai i aplikimit për punësim në administratën shtetërore (HRMIS pranë Departamentit të Administratës Publike) si edhe shërbimi për punësim në sektorin privat (IS Punësimi pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit). Shërbime të tjera si ai i deklaramentit të ndryshimit të adresës së banimit, aplikimit dhe regjistrimit në shkollat e larta, deklaramentit të taksave, regjistrimit të automjeteve etj. janë planifikuar për t'u zhvilluar.

- Shërbime ndaj biznesit G2B (Government to Business). Aktualisht grupi i shërbimeve ndaj biznesit është grupi, i cili ka pasur zhvillimin më të madh. Në të përfshihen Sistemi i Regjistrimit të Bizneseve, Sistemi Elektronik i Prokurimit Publik, Sistemi i Deklarimit Elektronik të Taksave, Sistemi i Licensimit të Bizneseve, etj. Këto sisteme janë operacionale prej mëse 2 vjetësh. Gjithashtu sisteme të reja në këtë grup janë duke u zhvilluar ose janë në proces planifikimi.

- Shërbime për punën e administratës shtetërore G2G (Government to Government). Në grupin e shërbimeve për punën e administratës qendrore implementimi i Interoperabilitetit ndërmjet sistemeve si edhe ndërtimi i sistemit të shkëmbimit elektronik të dokumentave, të cilat janë në proces zhvillimi ndërmjet projektit IPA 2009 do të mundësojnë lehtësimin e punës së administratës duke rritur efikasitetin e saj.

Vlerësimi i treguesve për qeverisjen elektronike (e-gadishmëria) është shpesh i vështirë, por bazuar në raportet dhe treguesit ndërkombëtarë ky vlerësim bazohet në drejtimet e mëposhtme:


- Krijimi i infrastrukturës për qeverisjen elektronike
- Ofrimi i shërbimeve të qeverisjes elektronike
- Shkalla e përdorimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike.

Komponenti i parë ai i infrastrukturës ndahet kryesisht në dy nënkomponentë atë të Infrastrukturës së brendshme të qeverisë për të mundësuar shërbimin, si edhe të infrastrukturës kombëtare për të aksesuar shërbimet.

Në drejtim të infrastrukturës së brendshme AKSHI, duke filluar nga viti 2008 ka koordinuar dhe implementuar disa projekte, të cilat kanë mundësuar përmirësimin rrënjësor të infrastrukturës së pajisjeve bazë të punës së administratës, po përfundon ndërtimin e intranetit të plotë sistemit qeveritar (rrjeti GovNet) dhe implementimin në të të shërbimeve

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II


bazë, nëpërmjet projektit IPS Trust Fund. Përsa i përket nënkomponentit tjetër, atë të mundësisit të përdorimit të shërbimeve, treguesi matës është shkalla e përdorimit të Internetit. Bazuar në të dhënat e ITU-së në fund të vitit 2009 shkalla e përdorimit të Internetit në Shqipëri është 41.2% (sot vlerësohet mbi 46%). Në grafikun e mëposhtëm jepet ecuria e shkallës së përdorimit të Internetit në vendin tonë.



Sikurse vihet re edhe nga grafiku i mësipërm, përdorimi i internetit është rritur ndjeshëm në dy vitet e fundit, praktikisht duke pasur një rritje eksponenciale. Në figurën e mëposhtme jepet shkalla e përdorimit në vendet fqinjë si edhe niveli mesatar i 27 vendeve EU dhe ai botëror.

Siç duket edhe nga ky grafik, në këtë drejtim ka akoma edhe shumë për të bërë me qëllim arritjen e mesatares Europiane. Projekti, i cili do të ketë një impakt më të madh në këtë drejtim është ai i PAP (Public Access Points), i cili po zhvillohet në bashkëpunim me Postën Shqiptare dhe do të mundësojë aksesin në shërbimet elektronike për të gjithë shtetasit, në mbi 1000 kompjutera të vendosur në zyrat postare, duke ndihmuar shumë përdorimin e internetit për aksesin e shërbimeve publike kryesisht në zonat rurale.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II



Të dhënat nga ITU 2009

Komponenti i dytë, ai i ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike ka pasur një zhvillim të ndjeshëm në 3-4 vitet e fundit në drejtim të ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike. Në një vëzhgim të përgjithshëm në grafikun e mëposhtëm, jepet situata aktuale për këtë komponent për 20 shërbimet.



Krijimi i portalit e-Albania.al, www.e-albania.al (kontakt: info@akshi.gov.al), ka krijuar mundësinë e marrjes së informacionit për shërbimet publike bazë në një pikë të vetme. Në këtë faqe ofrohet informacion në rrugë elektronike për një sërë shërbimesh të nevojshme për qytetarët, biznesin dhe qeverinë.

Nëse do të bënim një paraqitje të shkallës së sofistikimit të njëzet shërbimeve sipas metodës Capgemini, që përdoret gjerësisht në BE, niveli i sofistikimit të shërbimeve në vendin tonë kundrejt vendeve të tjera Europiane do paraqitej si më poshtë:

Grafiku pasqyron faktin që një pjesë e mirë e shërbimeve ofrohen sot në nivelet e para të tyre, kryesisht në dhënie informacioni dhe shkarkim formularësh. Kjo tregon gjithashtu se pavarësisht progresit të bërë në vitet e fundit, duhet intensifikuar puna për të rritur shkallën e ofrimit

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

të shërbimeve në nivele interaktive. Shembulli pozitiv i implementimit 100% të sistemit të prokurimit elektronik duhet të ndiqet dhe për shërbimet e tjera. Në grafikun e mëposhtëm jepet situata në Europë dhe Shqipëri për prokurimin elektronik.



Komponenti i tretë, ai i përdorimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike varet shumë nga zhvillimi i dy komponentëve të mësipërm si edhe lehtësisë dhe sigurisë për përdorimin e shërbimeve. Ky komponent ndahet kryesisht në dy nënkomponentë atë të lehtësisë së përdorimit të shërbimit dhe nënkomponentin e sigurisë së përdorimit të shërbimit.

Në drejtim të lehtësisë së përdorimit të shërbimeve AKSHI ka ndërtuar portalin “e-Albania”, i cili jep informacione fillestare në lidhje me shërbimet e vlefshme sot për e-Qeverisjen. Ky është praktikisht një website informativ, i cili mundëson informimin e përgjithshëm mbi shërbimet që ofrohen nga administrata publike dhe drejton përdoruesit drejt sistemeve, të cilat e ofrojnë këtë shërbim. Praktikisht ky website mund të konsiderohet si hapi i parë për organizimin e shërbimeve mbi bazën e parimit “*të orientuar ndaj qytetarit*”.

Në drejtim të sigurisë së përdorimit të shërbimeve, sot çdo sistem përdor mekanizmin “**emër përdoruesi – fjalë kalim**” (username, password), për rrjedhojë qytetarët apo bizneset janë të detyruar të marrin për çdo sistem elektronik elemente të veçantë identifikues (username, password). Kjo përbën problematikë si nga ana e qytetarëve apo bizneseve ashtu dhe nga ana e vetë institucioneve administrues të sistemeve. Aktualisht sistemet elektronike të ndërtuara janë të shoqëruara dhe me website përkatëse, të cilat përbëjnë ndërfaqen e tyre me përdoruesin. Përdorimi i këtij mekanizmi ka një problem për përdoruesin, që sa vjen zmadhohet me rritjen e numrit të shërbimeve elektronike.

Ky problem ka të bëjë me mbajtjen mend të adresës në internet të shërbimit elektronik si dhe kredencialeve përkatëse për t’u identifikuar nga ai shërbim. Këto problematika mund të përmbliidhen si vijon:

- Qytetarët apo bizneset duhet të mbajnë mend shumë elemente identifikues, që në praktikë është shumë e vështirë për të mos thënë e pamundur.

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II

- Qytetarët apo bizneset në rastin e humbjes apo harrimit të elementeve identifikues duhet të paraqiten në institucionet përkatëse të pajisur edhe me kërkesë zyrtare për t'i rimarrë këto elemente.


- Çdo institucion duhet të krijojë struktura help desk, të cilat në 80-90% të rasteve përballen pikërisht me dhënie të elementëve identifikues (sot pranë sistemit të prokurimit publik punojnë dy punonjës, të cilët japin elementët identifikues).

- Kjo mënyrë menaxhim ka problem të mëdha dhe në sigurinë e shërbimeve, pasi nuk mund të garantohet autenticiteti i veprimeve në shërbimet elektronike nëse kredencialet janë kaq të hapura.


Krahas vlerësimit të shkallës së ofrimit të shërbimeve, është shumë e rëndësishme të ndiqet dhe shkalla e përdorimit të këtyre shërbimeve. Në këtë drejtim duhet mbajtur parasysh që ofrimi i shërbimeve publike interaktive në vendin tone ka filluar kryesisht në dy vitet e fundit.

Duke u nisur nga të dhënat e vëzhguara në shërbimet e taksës elektronike, në sistemin e prokurimit publik, në qendrën e regjistrimit të biznesit, por dhe në portalin www.e-albania.al, situata e përdorimit të shërbimeve për marrje informacioni dhe shërbime interaktive gjatë periudhës 2008-2010 jepet në grafikët e mëposhtëm:

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II



Të dhëna për përdorimin e sistemeve në nivelin 1 dhe 2 të ofrimit të shërbimeve




Të dhëna për përdorimin e sistemeve në nivelin 3 dhe 4 të ofrimit të shërbimeve

Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II


Një rritje të ndjeshme ka përdorimi i shërbimeve të taksës elektronike për vitin 2010 kundrejt vitit 2009 po kështu rritje të ndjeshme ka pasur në periudhën 2008-2010 për sistemin e prokurimit elektronik dhe qendrën e regjistrimit të biznesit. Portali e-albania.al, edhe pse i krijuar në fund të vitit 2009, ka një rritje të ndjeshme të numrit të vizitorëve të tij.

Një situatë më e detajuar për shkallën e përdorimit të shërbimeve të taksës elektronike nga biznesi sipas aplikimeve të përdorura jepet në grafikët e mëposhtëm.



Të dhëna për përdorimin e sistemeve në nivelin 1 dhe 2, shkarkim formularësh sipas klasifikimi të biznesit

Të dhëna për përdorimin e sistemeve në nivelin 3, deklarim elektronik sipas klasifikimi të biznesit



Roli dhe zhvillimi i E-Gov në Shqipëri, pjesa II